

I afirmuar që në vitet shtatëdhjetë, Bardhyl Londo është sot një nga poetët më të rëndësishëm të letërsisë shqipe. Falë talentit dhe energjisë së tij krijuese, ai është ndër të rrallët që ka vazhduar të botojë me sukses edhe pas viteve nëntëdhjetë, duke mos u shkëputur asnjëherë nga poezia, pavarësisht angazhimeve të tij në politikë dhe në jetën shoqërore të vendit.

Bardhyl Londo

Kam një lloj frike t'i lexoj librat e mi pas botimit

Intervistoi Bujar Hudhri



GJEOGRAFIA E MELANKOLISË

nga Ylljet Aliçka (fq. 17)

Në vitin 2010 gazeta "The Economist" botoi një artikull mbi "gjeografinë e lumturisë", ku Bullgaria së bashku me Rumaninë u deklaruan si vendet më të mërzitshme në botë. Shqipëria nuk figuronte në këtë klasifikim.

Një vit më vonë shkrimtari bullgar, Georgi Gospodinov, botoi romanin e tij, "Fizika e trishtimit" gati si një përgjigje ndaj artikullit të mësipërm, por në një plan më të gjerë...



Ndërmjet të së dielës – 23.08.1863, deri në të dielën e tanishme: - 23.8.2020, kanë kaluar plot 157 vjet – nga fillesa e artit fotografik në truallin shqiptar. Gjer më tani nuk është përmendur hiç e diela e gëzueshme e atij gushti që solli edhe te shqiptarët artin me vlera të veçanta: Fotografinë...

JOZEPH SZÉKELY DHE EVA SHQIPTARE

nga Besim Fusha

Bazuar në dokumenta të kohës, në shkrimet plot saktësi të albanologut dashamir Johan Georg fon Han (1811-1867), si edhe në shënime ase ditarëve të shkodranëve të mençur dhe konsujve vendas dhe të huaj që operonin në Shkodër... - i përzënë të thënat ndryshe. Shkëputur nga studimi prej 400 faqesh – ja e vërteta që solli... (fq. 6)

Dramat *Lojë mbasdreke* dhe *Kandilja e argjandit*, të Martin Camaj

DRAMATIKA E NATYRËS SURREALE

nga Behar Gjoka (fq. 12)

Pjesë e vlerës së krijimtarisë letrare, të gjerë dhe përplot larmi të Martin Camajt është edhe dramaturgjia, madje ajo shënon edhe njërin prej shenjave letrare më impresionuese, gati e harruar prej historiografisë...

LEXIMI I SHENJË- ZIMEVE POETIKE

nga Sali Bashota (fq. 14)

Në letërsinë bashkëkohore shqipe, Demë Topalli, shquhet si poet dhe përkthyes. Ka botuar veprat me poezi "Vera e ikur" (1978), "Druri i fatit" (1972), "Haber i mirë" (1991) dhe "Sytë që dinë me pa" (2016). Në fushën e përkthimeve, duhet përmendur librin teorik të autores kanadeze, Linda Hutcheon, me titullin "Poetika e postmodernizmit: historia, teoria, fiksioni"...

ISABEL ALLENDE

Pse shkruaj?



BIBLIOTEKË

SKËNDER RUSI (fq. 8)

Fitorja e ngadalshme

ESMERALDA SHPATA

Logu i maceve (fq. 9)

RIGEL RIZAJ

Alza (fq. 10)

ALEKO LIKAJ (fq. 10)

Një ditë me Lasgushin

INTERVISTË ME SHKRIMTARIN
DHE POETIN E NJOHUR

**ROBERTO
BOLAÑO:** (fq. 16)

Kudo ndihem i huaj

I afirmuar që në vitet shtatëdhjetë, Bardhyl Londo është sot një nga poetët më të rëndësishëm të letërsisë shqipe. Falë talentit dhe energjisë së tij krijuese, ai është ndër të rrallët që ka vazhduar të botojë me sukses edhe pas viteve nëntëdhjetë, duke mos u shkëputur asnjëherë nga poezia, pavarësisht angazhimeve të tij në politikë dhe në jetën shoqërore të vendit.

Bardhyl Londo

Kam një lloj frike t’i lexoj librat e mi pas botimit

Intervistoi Bujar Hudhri

Le ta fillojmë me familjen dhe të afërmit tuaj. Cili prej tyre është marrë me letërsi?

I pari jam unë. Nëna dhe babai nuk kishin kohë të merreshin me letërsi se duhet të rrisnin fëmijët. Të vetmet që i janë afruar letërsisë janë dy vajzat e mia sepse kanë mbaruar për komunikim mediatik njëra në universitetin amerikan në Bullgari dhe tjetra në Mynster. Të dyja punojnë në zanatin e tyre: e madhja në Universitetin Shqiptar të Medias e dyta në universitetin e Hofenhaimit në Gjermani.

Si fëmijë çfarë librash pëlqenit të lexonit. Cili ishte libri më i dashur?

Në kohën e fëmijërisë sime librat e shkrimtarëve shqiptarë ishin shumë të paktë, për të mos thënë mungonin fare, por boshllëku mbushej me autorë të huaj, kryesisht rusë, si Nosov, Arkadi Gajdar etj., të cilët për të thënë të vërtetën, ishin shkrimtarë shumë të mirë.


Mbaj mend që libri i parë të cilin nuk e kam lëshuar nga dora ka qenë “Din Paku dhe Din Shumi”. Nuk jam shumë i sigurt për autorin por më duket se ka qenë Nosov. Edhe tani qesh kur kujtoj skena nga ai libër. Madje po ta gjeja mund ta përktheja për fëmijët e sotëm.

A shkruanit kur ishit fëmijë?

Natyrisht që shkruaja gati çdo ditë. Më të shumtat ishin imitime nga ata pak shkrimtarë që më binin në dorë. I kisha nisur edhe disa vjersha revistës “Fatosi” e cila megjithëse nuk m’i botoi, kryeredaktori i saj, Tuni Papucciu, më ktheu një përgjigje plot mirësjellje ku më shpjegonte përse nuk mund të m’i botonte vjershat. Ishte një korrektësi që nuk do ta harroj asnjëherë.

Kur keni botuar për herë të parë?

Në rast se nuk do të quajmë botime ato të rretheve letrare (atëherë krijuesit ishin shumë të organizuar nëpër rrethe letrare), botimi i parë serioz ishte në faqen letrare të gazetës “Zëri i Rinisë” me redaktor shkrimtarin e njohur Vath Koreshi i cili jo vetëm më priti shumë mirë, por më dha një faqe të tërë të gazetës, gjë që më mrekulloi, më gëzoi dhe më nxiti shumë. Qysh atëherë më lidhi një miqësi e vërtetë me Vath Koreshin. Ishte shembulli i redaktorit jo vetëm profesionist, por edhe njeriut e shkrimtarit të



vërtetë. Shumë libra, midis të cilëve edhe “Kur perënditë ndaluan vetëvrasjen”, një nga librat më të mirë të mi, të cilin e kam botuar tek shtëpia juaj botuese “Onufri” kur ju ende ishit në Elbasan, përpara botimit e ka lexuar Vathi, madje dhe kopertinën, një fragment pikturë nga Salvador Dali, e zgjodhi ai.

Ndërsa vjershat e para në “Drita” m’i ka botuar Ismail Kadare. Qarkullonin atëherë fjalë për tipin e akullt të tij dhe për mospërfilljen e krijimtarisë së të tjerëve, sidomos të rinjve. Gjithë ndrojtje nuk u ngjita në redaksi por i lashë poshtë tek dezurni. Megjithëse ishte ditë e mërkurë a e enjte për çudinë time, njëra prej vjershave, ishte botuar qysh të dielën. Ismaili jo vetëm i kish lexuar por edhe botuar në rastin më të parë.

Po librin e parë? Çfarë ndryshoi tek ju botimi i librit?

Librin e parë e kam botuar më 1976, kur ende isha mësues. Për të u kujdes shumë miku im Xhevahir Spahiu i cili në mungesë time takohej dhe nxiste redaksinë e poezisë të shtëpisë së vetme të botimit.

Natyrisht që libri i parë, sidomos atëherë, ndryshonte shumë gjëra. Në Lidhjen e Shkrimtarëve u organizua diskutimi i librit, ndërsa gazeta “Drita” i kushtoi një faqe të plotë diskutimit, gjë që atëherë donte të thoshte shumë. Ndërsa në Përmet filluan të më shikonin me sy tjetër. Për fat të keq kërkesave të herëpashershme të gazetës “Drita” për të më marrë në ekipin e saj, i përgjigjeshin gjithmonë negativisht. Përgjigje, sa për të qeshur aq dhe për të qarë, ishte e njëjtë: është shkrimtari tonë, e kemi rritur vetë... Pse s’më lini të shkoj, pse më pengoni kështu, i thashë një ditë sekretarit të partisë që drejtonte propagandën. Ke nevojë të njohësh jetën, më tha. Po pse ajo që bëhet në Tiranë nuk është jetë? i thashë.

Kur i keni thënë vetes “po, jam poet”?

Unë mendoj dhe provoj gjithmonë të njëjtën ndjenjë qoftë edhe kur botoj një vjershë të vetme: si do të pritet ajo nga të tjerët. Unë nuk jam narcisist që ta quaj gjithçka që shkruaj të përfunduar dhe të kënaqur. Kjo do të ishte vetëvrasje për çdo krijues. Kërkimi, ndoshta dhe mosbesimi, janë ato që e çojnë përpara një krijues. Unë gjithmonë jam pak i dyzimtë, për të mos thënë i trembur, për gjithçka që shkruaj. Shpesh herë kam një lloj frike t’i lexoj librat e mi pas botimit.

Keni shkruar libra me poezi, një libër me kujtime dhe një roman. Ku ndjeheni si në shtëpinë tuaj?

Natyrisht që poezia është shtëpia ime. Në të hyj pa përdorur çelësa fare dhe pa e ndezur dritën kur është errësirë. Por libri “Jeta që na dhanë”, një roman i gërshtetuar me esenë dhe i bazuar në kujtime reale, është nga librat më të mirë që kam shkruar. Për fat të mirë ai u lexua masivisht, ndërsa shtypi për një muaj të tërë u mor me të. Më vjen keq që romani “Nata e verbër” kaloi po thua pa u vënë re... Po ju siguroj se nuk është faji i romanit. Për të ruajtur etikën dhe edukatën time nuk është rasti të përmendim këtu atë që ndodhi me romanin “Nata e verbër”.

Të shkruarit, ju jep energji apo ju sflit?

Të shkruarit gjithmonë më shpëton prej depresionit, prej ndjenjës së boshllëkut dhe kotësisë. Sa herë



që jam bosh dhe e ndjej se nuk kam çfarë them bie në depresion dhe bëhem i bezdisshëm për veten dhe për të tjerët. E ndjen veten si ai burri që ka ëndërruar gjatë për një grua dhe kur e ka gati të zhveshur në krevat nuk është i aftë të bëjë dashuri me të.

A keni menduar ndonjëherë të botoni me pseudonim?

Kurrë. Më duket sikur kthehesh në ilegal, sikur nuk ke besim tek vetja, dhe, duke dashur të fshihesh nga lexuesi, e fyen atë.

A keni ndonjë libër të pabotuar? Nëse po, përse?

Libër jo, por vjersha po. Arsyeja është e thjeshtë: se kisha frikë sidomos nga aludimet dhe interpretimet dashakeqe apo subjektive që mund t'u bëheshin dhe kjo më ka ndodhur shpesh here që në dhjetor 1990 kur botova ciklin “Nga fletorja e demokracisë”. Të dy krahët e politikës i interpretuan sipas oreksit, të dy ma thanë në sy se kishin mbetur të pakënaqur. Por tani pothuajse

i kam botuar të gjitha.

Keni botuar para viteve 90 dhe tani me botues privat. Mund të bëni dallimin dhe të na e shprehni?

Është si dita me natën. Para viteve 90 gjykohej jo libri në tërësinë e vet por në radhë të parë përmbajtja dhe pastaj vinin të tjerat. Të tjerat, elementët artistikë, ishin të dorës dytë dhe të tretë. Tani ka probleme të tjera, probleme me sponsorët, me lekët që kërkojnë botuesit jo seriozë. Këta lloj botuesish nuk e lexojnë fare librin por numërojnë vetëm lekët. Prandaj tregu është mbushur me libra aq të dobët dhe të palexueshëm, të padenjë për t'i quajtur libra.

Përvojën e parë me botues privat e kam pasur pikërisht me ju, me shtëpinë botuese Onufri, kur ishit ende në Elbasan. Ishte libri i parë që më shijonte. Brenda një muaji u përgatit dhe doli në shtyp duke plotësuar një për një kërkesat e mia që nga njëherë mund të ishin edhe të ekzagjeruara. Atëherë drejtoja gazetën Drita dhe më kujtohet se në një shkrim e kam quajtur Elbasanin “kryeqyteti i botimeve”.

Për më tepër vija nga një eksperiencë shumë e hidhur. Libri “Si ta qetësoj detin” e ka pasur fillimisht titullin “Vetëm Itaka”. Botuesit i trembte aq shumë fjala “Itaka” sa nuk ma pranuan në asnjë mënyrë. Vetëm në Prishtinë Ali Podrimja e botoi me titullin që i kisha vënë në fillim.

Jeni një poet i suksesshëm dhe me karrierë të gjatë. Çfarë është suksesi për ju?

Suksesi është si ajo vera e mirë për të cilën të gjithë kanë nevojë. Por duhet të pinë aq sa të mos dehen.

Cila është ajo periudhë e jetës tuaj kur kini shkruar më shumë?

Ndoshta fillimi i viteve ‘90 për shkak të ngjarjeve politike por dhe tani kam një periudhë shumë të mirë.

A i lexoni shkrimet për librat tuaj? Si ndjeheni?

Kur i marr vesh po. Këto ditë lexova një shkrim të Kujtim Matelit për poezinë time “Itaka”. Të them të drejtën u ndjeva mirë se e kishte zbërthyer shumë bukur poezinë. Kur shkruajnë gjëra që mua as më kanë shkruar ndërmend, buzëqesh dhe them me vete “secili ka të drejtë të mendojë si të dojë”.

Në poezitë e librave tuaj ka ndonjë sekret që vetëm ju e dini?

Po, ka shumë, madje jo vetëm tek unë por tek shumica e poetëve. Ka vargje apo edhe poezi të tëra që shumicës iu duken fare normale. Por ka ndonjë femër që vetëm ajo e deshifron kodin e fshehur.

Në vitin 1981 apo 1982 pas ngjarjeve të përgjakshme në Kosovë, shkrova poemën “Vajzë e vogël me jetë të madhe” e cila në pamje të parë duket si një poemë kundër dhunës. Dhe vërtet ashtu është, por është kundër dhunës në Kosovë. Unë nuk mund ta thosha këtë se na ishte dhënë urdhri as të mos e përmendnim emrin e Kosovës. Këtë të drejtë e kishte vetëm “Zëri i popullit” i cili shkroi nga dy artikuj redaksionalë. Atëherë përdora mënyrën tjetër që vetëm unë e di: po të lexosh shkronjat e para vertikalisht të dy këngëve të



Bardhyl Londo Nata e verbër

BOTIMET TOENA



fundit, tek e para do të të dalë fjala Kosovë, tek e dyta fjala Prishtinë. Të tilla ka plot, ashtu siç ka vjersha që i kuptojnë mirë dhe e dinë si dhe pse janë shkruar, ndryshe nga lexuesi zakonshëm që nuk ka si t'i dijë këto.

Ndonjë poezi apo vargje që keni shkruar dhe e mbani mend?

Poezi timet është vështirë të mbaj mend, ndërsa vargje të veçantë, po. Gjithsesi më tepër mbaj mend vargje dhe poezi të të tjerëve. Ka ndodhur, për shembull me vjershën e Pushkinit “Sa ju kam dashur” që e kam cituar në fb direkt nga kafeneja. Ja po bëj një provë dhe tani:

Sa ju kam dashur. Ndoshta dashuria

*nuk është shuar krejt në shpirtin tim.
Po s'dua që prej dhimbjeve të mia
të ngryseni sërish në dëshpërim.*

*I heshtur e pashpresë u përvëlova
me ndrojtje, xhelozë dhe mall për ju,
po kaq me dëlirësi ju dashurova
sa dhëntë Zoti ju dashtë tjetër kush kështu.*

A dëgjoni muzikë kur shkruani? Në se po, ç' lloj muzike?

Jo, nuk dëgjoj muzikë. Tani në verë apo në dimër kur është shumë ftohtë dëgjoj zukamën e kondicionerit.

Keni një vend të veçantë ku shkruani apo mund të shkruani kudo?

Natyrisht kam tavolinën time. Por poezinë më tepër e shkruaj kur jam në lëvizje, me mend. Atje më vjen motivi, më lindin edhe vargjet kryesorë. Tavolina shërben pastaj për ta përfunduar dhe për ta lëmuar.

Meqenëse jeni poet ka kuptim kjo pyetje tani: shkruani me laps, stilolaps, apo stilograf?

Asnjërin nuk përdor më prej tyre. Pjesën kryesore e shkruaj me mend, në lëvizje, atë që mbetet ulem e përfundoj në kompjuter.

Zakonisht shkruani në mëngjes, pasdite apo natën?

Ishte një kohë kur shkruaja vetëm natën pasi binin njerëzit e shtëpisë në gjumë. Tani që jam vetëm me vajzën e madhe shkruaj në mëngjes.

Si i vendosni titujt e librave? Cila është domethënia e titullit?

Titulli është një nga proceset më të rëndësishme

të krijimit të librit, sepse pas emrit të autorit është i pari që krijon marrëdhënien me lexuesin.

A jeni i pranishëm në rrjetet sociale?

Po përdor fb kryesisht për poezi.

Keni ndonjë ide se si po ndihmojnë rrjetet sociale dhe interneti në zhvillimin e poezisë?

Po, them se ndihmojnë në përhapjen e poezisë. Në fillim më është dukur si diçka e pavlefshme, por aty kam njohur poetë dhe sidomos poetesha që janë shumë më të mira nga ato që pushtojnë ekranet e televizioneve. Sidoqoftë libri është i pazëvendësueshëm sepse krijon një ide të plotë për autorin. Mund të shkruash një, dy apo edhe dhjetë vjersha të bukura e prapë të mos jesh poet. Ta gjykosh poetin jo nga libri po nga fb është njësoj si të gjykosh paraqitjen e njeriut duke parë veç sytë, veç hundën, veç gojën etj. Kështu nuk gjykon dot kurrë ose do të gjykosh krejt gabim.

Ju pëlqejnë promovimet e librave tuaj dhe takimet me lexuesin, autografët?



Është mënyra më e mirë për të ngrohur atmosferën midis shkrimtarit dhe lexuesit por edhe për të shitur libra. Për fat të keq ne nuk kemi arritur ta krijojmë këtë kulturë të domosdoshme, ku shumë vende të zhvilluara, përfshi dhe Amerikën, e kanë shumë të kultivuar.

A do të pranoni që librat tuaja të jenë edhe audio? Cilët aktorë do të preferoni?

Janë bërë disa poezi të miat video. Dhe tani vonë “Newsbomb” bëri video poezinë “Qyteti i vdekur” me interpretimin e Arben Derhemit. Vetë do të preferoja aktorë të rinj që i kam dëgjuar, që e kuptojnë shumë mirë poezinë, por nuk ua di emrat.

Keni përkthyer shumë poetë të huaj si Amichai, Voznesenskij, Majakovski, Zagajewski etj. A duhet të jesh patjetër poet të përkthesh poezi?

Kushti i parë është ta duash fort dhe ta kuptosh e njohësh mirë poetin që përkthen. Natyrisht, duke plotësuar këto kushte, në rast se je edhe poet është akoma më mirë.



LEXIMI I SHENJËZIMEVE POETIKE

nga Sali Bashota

HYRJE

Në letërsinë bashkëkohore shqipe, Demë Topalli, shquhet si poet dhe përkthyes. Ka botuar veprat me poezi “Vera e ikur”(1978), “Druri i fatit”(1972), “Haber i mirë”(1991) dhe “Sytë që dinë me pa” (2016). Në fushën e përkthimeve, duhet përmendur librin teorik të autores kanadeze, Linda Hutcheon, me titullin “Poetika e postmodernizmit: historia, teoria, fiksioni”, si një numër të madh esesh dhe tekstesh kritike të autorëve të huaj, të cilat i ka sjellë në gjuhën shqipe. Gjithashtu, kontributi i tij i pakursyer në fushën e kulturës dhe të veprimtarisë botuese, ndërlihet në mënyrë të veçantë me revistën letrare “Jeta e re”, e cila siç dihet botohet nga viti 1949 e këndeje dhe, pa dyshim, është revista më e rëndësishme letrare në Kosovë.

Funksionalizimi i paskajores

Demë Topalli hyn në mesin e atyre poetëve që kanë botuar pak vepra, por që kanë thënë mjaft, duke sjellë vargje të bukura para lexuesve. Prandaj, bota e tij krijuese strukturohet përmes shenjave e veta autentike. Pikërisht, aty shquhet koha dhe hapësira e pëshpëritjeve të zgjedhura shpirtërore, jo rrallë, me frymën e trajtave gjuhësore të paskajores, për të mbërritur efektin stilistik, figurativ dhe estetik. Vepra e tij poetike “Sytë që dinë me pa”, e cila përbëhet vetëm nga tridhjetë poezi, dëshmon një konceptim mahnitës lirik, i cili përthyeret me trajtat e ligjërimit lutësor, duke përcaktuar udhëtimin e ëndrrave të jetës, drejt cakut figurativ dhe mesazhit të funksionalizuar përmes ideve dhe motiveve të karakterizimit reflektiv. Në fakt, çdo poezi e ka ndjeshmërinë dhe ritmin e vet, natyrisht e parapëlqen kodin tematik dhe estetik, për ta funksionalizuar parimin krijues, kur gjërat konkrete dhe gjërat abstrakte, rikrijojnë përfytyrimin dhe shpërfytyrimin e harresës, mahnitjes, ikjes, durimit, vetmisë, mallit, etj. Demë Topalli është poet, i cili nuk vrapon pas figurave të zbehta as pas trajtave të mjegullta ligjërimore. Situatat, ngjarjet, detajet lirike apo metarrëfimet në poezinë e tij, e zbulojnë udhën e sigurt, nga fuqizohet dimensionin dhe kuptimi i meditimit lirik, ndjeshmëria e një urtie të mbivendosur në relacionet midis gjuhës, stilit, ritmit, figurës. Cilësia e këtij meditimi lirik e formëson botën e vet, për të shpërthyer në sfondin e përjetimeve të renditura sipas shkallëzimit të detajeve përjetuese, aty ku ka dhimbje, ka edhe edhe fat apo aty ku ka harrim, ka edhe dashuri. Po kështu, kumti i frikshëm, i përmendur shpesh në poezinë e Demë Topallit, e ka një lutje të pësëritur për ruajtje nga mallkimi: *me harrue me shkrue*. Poezia “Shtëpia e bërë prej harrese”, e shpjegon qartë ardhjen e frymëzimit, duke i konkretizuar tonet pasionante drejt gjurmimit të një parahistorie mijëvjeçare që ka të bëjë me ndjenjën e harresës, por edhe për rikthimin e besimit në vlerat më të admirueshme të jetës. Prandaj, në vetminë e poetit është ndërtuar “shtëpia e bërë prej harrese”, për ta shpjeguar kuptimin poetik të shenjave, të ndërlihdura me harrimin e shkrimit. Poezia e Demë Topallit, jo rrallë, brenda vetes e ka përballjen alegorike dhe paradoksale me tundimin (“Tundimi i parë”), pastaj shpërthimin e vazhdueshëm të imazheve ku “soset bota” (“Rënia e parë”). Për më tepër, dimensionin kuptimor i kësaj poezie e parapëlqen pjekurinë e frymëzimeve, për të formësuar ndjeshmërinë e qëndrueshme të procesit krijues, i cili e prodhon efektin e parë të ndikimit estetik, ku ndërlihdhen fijet e forta të fjalës dhe të mendimit, me një vargëzim enumeracionesh të bukura dhe të përzgjedhura me mjeshtëri. Cikli “Fjalët”, i përbërë nga pesë poezi, është kërkim i tëhollur i fjalëve “mos me vdekë pa rënë në letër” (“Ka çaste”). Poeti thotë: “Ka çaste/Kur mendimi mbyllet deri në errësim/Dhe fjalët vijnë krejt të sflitura, vdesin/ Vdesin ende pa ra në letrën e bardhë”/.

Për çdo poet, ballafaqimi me letrën e bardhë, është

akti më magjepsës i frymëzimit, aty ku fillon të thuret pasioni dhe ndjenja e trillimit të gjërave të bukura, të cilat e vëjnë komunikimin me fjalët, mendimet, figurat. Kërkimi më i veçantë, gjithsesi, është fuqizimi i ndjenjave, për ta ndërtuar harmoninë e mesazhit të shenjave emblematike që i prodhon ligjërimit. Poezia e Demë Topallit është filozofi e ekzistencës, e cila pikëmbështjen e ka tek formulimet e ëndrrës e të realitetit, ndonjëherë veç e veç, ndonjëherë bashkë. Më tutje, përjetimet bëhen copa kujtimesh të thërrmuara, aty ku flet një zot i mirë dhe kërkohet dalja nga cila derë. Përmasat e përballjes i situojnë ato shenjëzime poetike që kanë një artikullim të fuqishëm të fatit individual (“Kafaz”).


Gjithsesi, subjektiviteti krijues i kësaj poezie udhëhiqet nga urtësia e ligjërimit, nga ngadalësia e parqitjes së mendimeve të cilat ndërlihdhen me një objekt, dukuri, fenomen etj.

Esenca e së bukurës platonike në poezinë e Demë Topallit strukturohet përbrenda universit komunikues, aty ku e veçanta ballafaqohet me të përgjithshmen apo konkretja me abstrakten. Shtëpia dhe harresa, bëhen bashkë, pastaj qartësohet perceptimi i botës, përmes formulimit të mrekullueshëm poetik si gjetje fantastike: *shtëpia e bërë prej harrese*.

Lëvizja fluturake e frymëzimeve

Cikli “Heshti”, përbëhet nga pesë poezi. Janë këto pesë poezi si pesë shenja: *hapësirë, kohë, heshti, lutje, dashni*. Demë Topalli e ngulit një nocion të ri në ligjërimin e tij poetik, nocionin *heshti* (jo heshtje as heshtimë). Kështu, poezia “Heshti” e prodhon një lëvizje fluturake të frymëzimit, atëherë kur një gjeth i vetëm në degën e tharë, bie në barin e njomë. Aty ndërtohet filli i çdo gjëje të bukur, mahnitëse për poetin. Është ky një reflektim i imazhit për çastin: gjethi i vetëm, dega e tharë, bari i njomë, pastaj vargjet: Me vdekë/ Një mijë herë me vdekë/ E me u ngjallë bashkë me ty/Përsëri, në Heshti”/.

Kësomënyre, raporti mes imazhit, mendimit, ndjenjës, figurës, çastit, etj., sikur zhvillohet përbrenda nuancave të metafizikës dhe filozofisë, në radhë të parë, për ta fuqizuar detajin poetik me përsëritjen e fjalës *heshti*, edhe në përmbyllje të kësaj poezie të bukur. Sigurisht, asnjë art tjetër, nuk do ta kishte një kënaqësi të tillë të përjetimit estetik, për



ta fuqizuar, kaq bukur e kaq qartë, përshkrimin e detajuar të frymëzimit, të derdhur përbrenda vizionit dinamik të imazheve asociative.

Një ndër poezitë më të realizuara, pos poezive “Shtëpia e bërë prej harrese” dhe “Heshti”, është poezia “Lutje”. Lutja është nevojë shpirtërore e njeriut në çdo rrethanë jetësore, është zjarri i brendshëm i shpirtit, i ndezur midis perceptimit të së veçantës, për t’u bërë shenjëzim universal, në ëndërr e në jetë. Ruajtja e fshehtësisë së gjërave të bukura, ruajtja e mahnitjes së parë, ruajtja e dashurisë, e ëndrrave, etj., është shpjegim i vetëdijes krijuese, doemos, për t’u ruajtur uni, egoja, vetvetja. Është mishërim dhe fisnikërim i shpirtit të krijuesit, për të fuqizuar konceptin poetik dhe konceptin estetik për jetën dhe botën.

Cikli “Për një lule të paemër”, i përbërë nga poezitë: “Kam mall”, “Një takim ish-gjimmazistësh”, “Për një lule të paemër”, “Brenge” dhe “Një emër”, shenjon mallin përtej vetvetes, për ta përcaktuar pafundësinë e ëndrrave për një botë që nuk kthehet më, për një vetmi e cila lëkundet me ndjeshmërinë e papajtuar midis shpirtit dhe arsyes. Prandaj, poeti sikur e kapërcen sfondin e këtij ëndërrimi, për t’i dhënë funksion parësor ligjërimit poetik, përmes një empatie pozitive të ndërlihdur me ekzistencën. Fjalori poetik i kësaj poezie dëshmon për refleksionin krijues midis harmonisë dhe përsosmërisë së situatave dhe imazheve në projektimin e ideve dhe mesazheve dinamike për jetën.

Kësomënyre, *malli, emri* dhe *brenge* karakterizohen e funksionalizohen përbrenda asaj ndjeshmërie lirike, të fuqizuar nga reflektimi i atyre imazheve që shfaqen në forma ngjyrash e trajtash poetike të emërtuara me invencion krijues, pikërisht në një sfond tjetër të ekzistencës, siç ndodh në poezinë “Për një lule të paemër”, me vargjet e fillimit: “Kur unë vij e due me hy/Ti gjithnjë ik nga ky kafaz/Drejt një hapësire të pafund”/.

Poeti i mbindërtton pasionet dhe ndjenjat, ikjen dhe pafundësinë, për ta projektuar mendimin dhe kuptimin estetik për gjëra të veçanta dhe magjepsëse, të cilat e zotërojnë fushën e preokupimit krijues, ndërkaq hapësira e pafund asnjëherë nuk mbërrin në pikën përfundimtare, kështu që udhëtimi vazhdon nëpër kohë, edhe atëherë kur befasi vjen mahnitja e parë, por edhe atëherë kur ikën tundimi i fundit.

Demë Topalli e funksionalizon konceptin e shenjuar të fjalëve, duke e provuar kombinimin e elementeve përbërëse të përsëritjes, ritmit, figurave, etj., pikërisht brenda atyre raporteve ligjërimore përmes shumësive së përfytyrimeve, midis lojës së analogjive dhe lojës së kundërvënieve.

Cikli përmblyllës i librit “Sytë që dinë me pa”, me titullin “Ndoshta”, përbëhet nga nëntë poezi.

“Me Dashtë e Me Qenë i Lirë” (me shkronja të mëdha), është klithja poetike e Demë Topallit në poezinë “Shumë të falem, Mnemozina”. Kjo klithje e ka në pronësi shpirtërore vetë muzën deri në sajësën e ëndrrës, në atë dhomë plot dritë, por “edhe nën një qiell vetmitar me hanë”. Mrekullia e frymëzimit shkon më tutje, për ta përcaktuar afshin e kujtimeve e të imazheve për ruajtjen e vazhdimësisë së përjetimeve në skajin tjetër të kujtesës, aty ku janë; malli, fjala, dashuria, Zana, trupi e shpirti.

Karakterizimet e këtilla e fuqizojnë vizionin dinamik të jetës, duke rimarrë botën e miteve e të legjendave, për të riprodhuar efektin estetik dhe figurativ të simboleve e figurave të tjera, në poezitë e veçanta të këtij vëllimi, siç janë: “Një zemërim i lashtë”, “Në dhomën plot dritë”, “Mahnitja e parë”, “Votra”, “Lumi Stiks”, e ndonjë tjetër.

Vargjet impresionuese të këtyre poezive, të frymëzuara nga çaste dhe momente të ndryshme, nga ide e fakte njerëzore, mund të jenë shenja të veçanta krijuese që prodhojnë figurshmërinë e realitetit jetësor, ndërlihdur me legjenda e mite të moçme (figura e Mnemozinës, lumi Stiks).

Në poezinë “Votra”, vargjet me ndijime të holla, siç janë: “Shumë, shumë kisha dashtë/Sikur zoti im i parë, aq i mirë/ Të m’i jepte sonte një mijë palë sy/, e formësojnë botën e dashurisë për të zmadhuar pasionin e dëshirën, apo një alternativë tjetër të pamjes së bukur “me një mijë palë sy”.

Demë Topalli kujtesën e besueshme të frymëzimit e projekton si pamje magjike, duke e rritur pasionin për klithjen e tij poetike të vullnetshme. Mrekullimi “me një palë sy”, e ka bukurinë e vet përtej kujtimeve të zjarra e të pakrahasueshme.

Poezinë e poetit e përfaqëson frymëzimi “Sikur zoti im i parë, aq i mirë”, të jetë shenja kryesore e konceptit krijues dhe fjalës së shenjtë. Më tutje, po ky admirim është burim i ndjenjave, pikërisht me shfaqjen e dimensionit të hyjnore. Gjithsesi, një poezi e bukur që e ka emrin e vet.

(Prishtinë, gusht 2020)

Ndërmjet të së dielës – 23.08.1863, deri në të dielën e tanishme: - 23.8.2020, kanë kaluar plot 157 vjet – nga fillesa e artist fotografik në truallin shqiptar. Gjer më tani nuk është përmendur hiç e diela e gëzueshme e atij gushti që solli edhe te shqiptarët artin me vlera të veçanta: Fotografinë... Studimi shumëvjeçar “Pietro Marubi – ‘modestia’ që lodh përtej kohën”..., - e kallxon të vërtetën historike, krejt ndryshe nga ç’është shkruar më parë... Ngase, janë thënë veçse sajesa dhe hamendësi e shtirur, se gjoja fotografia shqiptare, fillon me figurën e Hamz Kazazit (1858) dhe Leonardo De Martinos më 1859, vazhdë që eci rrenacake deri në të shkruarat e gjermëkëtueshme...

Jozeph SZÉKELY dhe Eva shqiptare

nga Besim Fusha

Diku, në një nga caqet e pafundme të hapësisë së pamatë – në Hungarinë e Dheut tonë, afër Balatonit, në Sümeg (Shumeg)... në kapërcyellin kur stafeta ndërrohej që shtysën e saponisun ta ecte ndritimi – pra, në atë çast të kohësisë, në *albesin* e përpurtë të natë-ditës së premtë 02.02.1838, zëbuloi gëzueshëm e qara e parë e një fëmije. Djalë. Familjarët Székely, që mezi e prisnin, nuk u dymendsuan për emrin, por, njëherësh përzgjedhën JOZEF... si të vorbulluar në ekstazën shpirtrore edhe për *“Atin”*... kushediku, edhe për *Birin*... këtu. Dhe, u lutën pa hile për mbarësinë e Jozefit. Lumturuar dhe bindun se lutjen e patën adresuar në siguri... ikën, më saktë: *cikluan*... në përtejgjallesë pa shumë *“ufel”*... Gjithsesi, mbase vërtetë nën mëshirën e përzgjedhën nga *“Ati”*, Jozefi ynë nisi udhësinë e frymëmarrjes, që, thuajse pa zigzake, e vijoi goxha mbarë përaqsa ecuni që i qe caktuar si *kohë ciklike e gjallesës*... Vijoi pra ashtu siç i deshi xhani... përaqsa gjalloi mbi tabanin e dy shkurtit të vitit 1838, deri plot 63 vjet, tetë muaj e nja ca ditë...Vetëdija njerëzore dhe *cikli i gjallesës* e braktisën njëherësh Jozef Szekely-n, aty ku punoi, në Vienën austriake. E braktisën disi shpejt, atij mëngjezi shirrëke të së premtës, më 18.10.1901. Gjithsesi, Jozefi u rrit në mirësinë e njerëzve pa hile dhe ajrinë mes gjelbërimit, përbrinjë liqenit të Balatonit, pa u dembeluar... Dhe, as *qyl-zuar*... Mbaroi përsëmbari parauniversitetet në Szombathely (Sombateli). Filloi rishmëzi shkollimin dhe vijoi mirë. U diplomua me magjistër në farmakologji, në universitetin e Vjenës. Pati një ëndërr të fjetun për pikturën, por as e zgjoi, as nuk e cyti për studime... Dy vjet mbas diplomimit, më 1862 mori doktoraturë në kimi. Ende nuk dimë nëse trajtesa e doktoraturës synoi veçantë ate sferë të kimisë që i nevojitet arritjes fotografike... Nëse po ose jo, e vërteta është se mundi i studimit ia njënjëson disi pasionin dhe kohën për të dyja.... Ngase e pat ndarë mendjen: pat nisun pasionant edhe zotërimin e fotografisë... Qe koha kur fotografia e pat kapërcyer pragun e vetmbylljes dhe qe futur hallexheshë e pangjinun në oborrin e kimisë, ku, denjësisht e bindun, rrekej të vilte ç’i vlente për vrapin fotografik... Nuk do të themi se Jozef Székely studioi kimi me bindjen se deshi të thellohej në veçanësitë e ecunive shkencore në fotografi... ende nuk e dimë këtë. Sikundër dimë se studimet për kimi nuk e cytën deri aqsa të liqensohej me ndonjë shpikje shkencore të vlershme... Nuk e injorojmë arritjen shkencore Dr... qe goxha emërtim macahere, qe vlerë dhe nderim. Ama, Doktoratura veçse u arkivua. Gjithsesi, e vërteta është se fill mbas doktorimit në kimi, Dr. Székely u mirëpërcaktua, u fut shtruar në shinë... hapi atelie fotografie diku pranë operas në Vjenë, në Heinrichshaf...

PHOTOGRAPHIE
Von D^h SZEKELY WIEN
1. ELISABETH STRASSE 2

Dhe, nën këtë logo u rrit goxha *mbi*... namëzoi shpejt, qe zbatues korrekt, qe mjeshtër i kërkuar, nisi të vlerësohej si artist, mori çmime, madje edhe në botë, deri mes vlerave pariziane... Jozef Székely u bë fotograf i namshëm. U bë shpejt, qysh në vitet e para njëzet të vijimësisë së jetës. Në kult të famës, plot 25 vjeç e gjysëm erdhi edhe në Shqipëri. Erdhi në Shkodër dhe përgjatë Drinit. U përzgjedh të vinte. E përzgjedhi Akademia e Shkencave të Austrisë. Dhe kjo nuk qe vetëm rastësi fati. Qe edhe vlerësim profesional. Duhej për një punë të rëndësishme fotografike, kryesisht në vijëzimin udhëtues të Drinit shqiptar... Për të cilin Johann Georg von Hahn (Johan Georg fon Han) projekttoi studime të vlershme...

Gjithçka ndodhi në verë. Verë, 1863. Të martën me 23 qeshor, Han-i nënshkroi një letër adresuar Akademisë Austriake të Shkencave. Përgjatë rrjedhës së Drinit në udhëtimin shkencor, Han-i kërkonte edhe fotograf. (...pat nisun fotografia të shoqëronte shkrime vërtetësie, veçanërisht shkencore... qenë ilustrimet nismë që do ta thonin besueshëm saktësinë në vijimësi...). Dhe, Akademia caktoi edhe fondet. Do ndihma *“periferike”* si *barka të mbartëshme dhe ekuipazhin e nevojshëm* ia pat premtuar me bujari edhe dashamirësi i projektit, Kryeduka Maksimilian, pa u emëruar ende Mbret i Meksikës, premtim që e zbatoi Ministri i Marinës, baron fon Burger dhe që, veç barkave dhe ekuipazhit shtoi e dha me plot dëshirë edhe të gjitha instrumentat për matjet e nevojshme...

Gjermani albanolog Johan Georg fon Han (1811-1869), ndonse i pangjinun në çka synonte, e njihte shqipen dhe Shqipërinë, pat shkruar për shqiptarët dhe botën plot tre volume të vlershme: “Studime Shqiptare” (Albanesische Studien – 1853 dhe 1854). Gjithsesi, kësaj here, Han-i erdhi më i mirëpaisun. Erdhi edhe qartësisht i përcaktuar. Erdhi së pari në Durrës. Zbriti në Durrës të mërkurën mbrëma, më 12.08.1863. Qe nisun nga Siros-i grek, ku qe përgjatë konsulli i Austrisë atje. Dhe, Han-i u vonua ca në Durrës. Kolegu i Han-it, Ballarin-i (që pat lindun në Shkodër në vitet e trazuara ’30, kur babai i tij G.P.Ballarín, që qe aq shumë aktiv...), i shtruar ato ditë nën ethe, iu lut të takonte *mudiri-n* (gubernatorin – turk) dhe të ndikonte për lirin e tetë klerikëve, që dyshohej se kishin fshehun e ushqyer do cuba... Han-i u lumturua kur e zgjidhi këtë ngatresë të *trishtueshme*, aq më shumë ngase, klerikët katolikë – të mbërthyer prej dy muajsh nga ethet – gati po vdisnin... Por, Han-i, si të kapte llapëveshin me gishtrijtë e krahut përtej, u vonua për në Shkodër, ngase, udhëtoi brigjeve të Erzenit për në Tiranë, përmes maleve shkeli në Mat, nga Mati në Lezhë, e me radhë... nëpër lumej, male e fshatra... vëzhgues i qëllimtë për zbërthime dhe trajtesa traditash, dokesh apo ç’synonte... Nga Durrësi u largua në mbasditën e së premtës, me 14.08.1863. Në këtë udhëtim plot ngarkesa u shoqërua edhe nga Jozeph Tedeschini (Josef Tedeskini) – djali i *agjentit të Lloyd-it* në Durrës dhe Gaspër-i besnik, që, edhe para nja dhjetë vjetësh, pat bërë çmos t’i largonte ethet dymujore që Han-in e bënë telef...



Jozeph SZÉKELY

U lodh ase u vonua Johan fon Han-i, gjithsesi, në udhëtimin për në Shkodër qe pa hungarezin Jozef Székely. Në Shkodër do të takoheshin. Albanologu qe nisun nga Siros-i grek dhe Durrësi... fotografi nga Vjena dhe Tivari verior... Me plot ngarkesë dhe bashkë me shoqëruesit jashtëprofesional, fotografi shkeli dhe fjeti në Tivarin malazet në natën e datës 19.08.1863, plot një të mërkurë më mbas kur Han-i pat zbritur në Durrës. Jozef Székely nuk u largua nga Tivari pa siguruar një fotografi. Nuk dimë nëse për qytetin bregdetar, me plot ardhje-ikje të huajsh, pati ase jo fotografi të mëparshme, ashtu sikundër dimë se, për Jozef Székely-n, fotografia e Tivarit renditet e para në arkivin e tij të përkatësisë ballkanike... Gjithsesi, Székely me shokë apo ç’kishte përanash vetes... udhëtoi më shumë se një gjysëm dite dhe sosi në Shkodër të enjten me 20.08.1863. Dhe, Jozef Székely, priti e priti në Shkodër, derisa u shqetësua. U merakos për Johan fon Han-in. Në të vërtetë u merakosën të gjithë: edhe miku i vjetër i albanologut – Dr. Auerbah, shoqëruesi përgjegjës, togeri i marinës fon Shpaun, apo edhe kolegu i Hani-it, konsulli Dubravçiq. Qe e pranueshme të vonohej paksa, por, ndryshe nga ç’qe thënë, Han-i u vonua një javë. Udhëtoi lodhshëm e ngeshëm, ngase, u ndesh me ç’nuk priste... u largua e nisi ta lente mbas shpine Lezhën, vetëm në orën dy të ditës së pazarit javor, të mërkurën, me 26.08.1863. Dhe, udhëtuan përngutun plot tetë orë, patën pushuar nja një gjysëm ore sa për një kafe, dhe, në orën dhjetë e gjysëm, trokitën në derën e Konsullatës së Shkodrës. Në sallonin e mikpritjes sosi njëherësh edhe gëzimi... Loja e bixhozit uist (wist) u shprish... nisi sajdia, vena dhe rakia... nisën edhe rrëfenjat për çpatën sajaur, punuar e ç’vaki ndodhën, dhe, vetëm fare vonë u shtrinë, për ca energji sado, ngase ... *kemi punë dhe rrugëtim sapo të gdhim*... U tha se do të niseshin tutje rrjedhës së Drinit sapo të niste edhe ndritimi i pritshëm i së ejtes, më 27.08.1863. Por, përngutjen për tu nisun sapo të fekste agimi i ditës së ejte, e cyti hovi gaztor në vorbull muhabeti e pijesh. Ngase, mbas atij pak gjumi me më shumë gërhimia sesa ëndrra... u tha se ende nuk qenë gati... Sepërse, le të themi së pari: nuk mund të largoheshin me ngutje ngase, Dr. Székely, do të fotografonte “Skënderbeun...”

...udhëtimit për në Shkodër, Han-i, bujti dhe fjeti edhe në Delbnisht, në perendim të vargmalit të Krujës, nga ku s’duhej hiç dylbi për Detin, Fushë-Laçin dhe Breg-Matin... aty, në goxhafreski, majë kodrës pranë Kishës, në banesën e Monsinor Refaele Dambrozio-s. Kryepeshkopi i Krydiqezës me 18 famulli katolike – nga Durrësi deri në Lurën verilindore, nja 20 orë të macahershme që nga Delbnishti – qe *“kryebariu”* i nja 4000 katolikëve, që jetonin hapërdarë në 789 familje. Që të mos hapërdahemi lodhshëm, siç rrëshqet doherë e shkruara... ja ç’na duhet, vë re: Han-it i mbetën sytë te një pikturë e vjetër në dhomën e pritjes së Refaele-s. Dukej profili plot energji i një të moshuari me beretë të kuqe... U tha se qe portret i Skënderbeut. Dhe, meqë qe i papamë për Han-in, iu lut Kryepeshkopit ta merrte deri në Shkodër, ta fotografonte Dr. Székely dhe ta përballte Han-i pastaj me kusha piktura të Skënderbeut në Itali. Por fotografimi dështoi. ... *nuk doli aspak i mirë*. Ngase, piktura, qe me rudha dhe *kishte shumë valëzime*... Kështu, ... *zoti Dr. Székely, vizatoi një kopje të saktë të kokës, për të bërë mbi këtë bazë retushimin e fotografisë*.

Han-i gabon kur thotë se piktura s’doli mirë ngase *kishte shumë valëzime*... Njeriu i mjeshtërisë fotografike do të dyshonte. I gjendet dërmani *rudhimit* për çka flet albanologu, jo vetëm me shkrepje e dystim... por, edhe ngase, fotografi, nuk pati aparaturën përkatëse. Dhe, këtë, jo se nuk e tha para fotografimit... I paisun për fotografime panoramike, nuk pati objektivë fokusivë nën normalë për riprodhimin e pikturës me përmasa kuadrative nën metroshe... Se, objektivë nën normalë, ende nuk qenë shpikur... Gjithsesi, mangësinë teknike ksorasti, po e quaj favor të fatit, ngase, më dijenon për së pari, aftësinë e Székely si piktor. Që, sikur e kemi thënë, nuk e cyti tutje aqsa... deri në përpjekje shkollimi për evoluim. Gjithsesi, qe dhunti që u rrit dukshëm në vlerë dhe ecuni përgjatë jetësimit të punëve fotografike.

Entuziazmi i dashjes për nisjen e përngutun, u shua në pak kohë mbasi u tha... paksa mbas gjumit të së ejtes, qysh në orët e para të dt. 27.08.1863... nisën përgatitjet që s’u bënë përshpejtuar... përpjekja e lodhshme për të qenë gati shtyu edhe ditë, jo më pak se tri... Qe kohë që u deshën parakryer mjaft detyra, kryesisht për sigurinë e udhëtimit... E, për ç’siguri kërkonte *siguria*... Georg fon Han-i, qe më i kthjellti. *“...kur po haja mëngjezin në Lezhë... për çudinë time më të madhe, mësova që, udhëtimin studimor nëpër lumin Drin, do të mund ta filloja që nga Shkodra (Skodra)... mbasi, në dimrin e viteve 1858 dhe 1859, kishte ndodhur shpërthimi i lumit në drejtimin veriperendimor të fushës së Shkodrës, duke mbërritur deri në skajin e saj jugor... Për dy dimra me radhë uji i Drinit u vërtit me egërsi anepëranë fushës që gjeti, duke shkaktuar dëmtime të mëdha. Në dimrin e tretë (1860) Drini hapi shtratin e ri... që bashkohet paksa përtej urës së Kirit (Kjirit) me lumin Kir në lagjen Tabakë, zonën më*

jugore të Shkodrës. ...nëpër shtratin e vjetër që la, mezi derdhet në det një e treta e nivelit të përgjithshëm të ujit...

Han-i pat qenë kësoane dhjetë vjet të shkuara dhe, për një riudhëtim në Drinin e ndryshuar, kërkohej siguri... Kur Han-i mungonte, togeri i marinës fon Shpaun pat siguruar vetëm një varkë. Por, vetëm një, nuk mjaftonte. Han-i, autoritar këtu edhe për nga detyra, iu desh t'i lutej prefektit Haziz Pasha edhe për dy varka... Pashai qe i gatshëm, madje, ndërhyi edhe për shoqërues me nga tre lundëtarë, djemnamshëm. Por, shkoi puna deri përtej Bunës, në Shirokë. Kryetari i korporatës nuk i dha varkat më poshtë se 20 franga në ditë dhe kjo, mbas fjalësh që u stivuan deri mirëkuptuese, u la siç u tha, sepse, u fol për vështirësi e rreziqe, përfshi edhe frikën e mundshme për kushediçka... në një rrugë të pashkelun.

Për sigurinë, gjithsesi, Pashai, prefekt, caktoi edhe dy *kavazë* (shoqërues). Katerajer, gjermani i shkathtë dhe korrekt i konsullatës, garantoi edhe ushqimet deri në Prizren. U pa e nevojshme që togeri fon Shpaun të bënte, për siguri, një *mbikqyrje* paraprake të rrugëtimit herë-herë shpërthyes të Drinit të ri. Kryesisht për të ditun në se diku edhe mund të ngecet në cektinë... Togeri fon Shpaun tha jo dhe u sigurua kështu në *“shetitjen”* e së djelës me plot diell të dt. 30.08.1863.

Sapo pat dëgjuar për ç’po *“sajohej”*, peshkopi i Zadrimës, monsinjor Severini, nguli me të madhe se duhej në ekip edhe një shoqërues klerik... Përzgjedhi Don Ëngjëll Bardhin dhe, në fund, Han-i u shpreh entuziast, ngase u bind për ç’qe dashun kleriku...

Kështu, e përgjithshmja, më në fund, qe kurdisun, moti vijonte të jetë xham... dhe, s’mbetej veçse të kurajoheshin për ate udhëtim plot veçanti dhe punë. Gdhiu mëngjez po aq i mirë të hënë me 31.08.1863, kur 15 burra (7 udhëtarë, 2 kavazë dhe 6 rremtarë), secili në vrullin e detyrës, i hipën varkave dhe plot entuziazëm e *humor të mirë* nisën të çanin Drinin e ri për të kapur, si fillim, Kalanë malore të Danjas (Daino). Ku, Han-i, si shkencëtar, u zhyt në vetminë e mendimit të thellë... (*Daino* – ital. – *Dagno* = në gjininë fem. të shq. = *Daina* – në rasën gjinore duhej thënë: *Dainese*... – mirpo thuhet *Wan Dense* dhe, më tutje edhe më keq: *Wau Deise*... dmth *Vau i Daina-s...*), burrat pranë rreknin trutë të rroknin gjuhë e kuptim... për shkëmbimin e batutave gaztore. Nja dy orë e gjysëm duheshin për të çarë kundërrymën deri në *Vau-n e Daina-s...* Por, mendësitë e hapërdara tejtutje në humorin gaztor... u çartën... njëra nga varkat nisi të fuste ujë. Duhej kthyer dhe, u kthye, shoqëruar me një *kavaz* (bodigard) që edhe do t'i lutej Pashait për zevendësim... *Kavazin* tjetër e nisën në fshatin Gavoc për ndonjë mundësi se si mund të kalohej nata: deri edhe *bujrum në konak*... siç thuhej kësoana... Por, koha eci më shpejt nga *kavazi*, u bë vonë dhe më, s’çoheshin larg bagazhet... vendosën të flinin sidosi në dy varkat e mbetuna, që i lidhën dhe mbërthyen për anash diku në zallishte.

Dhe...

...duart e votës u ngritën për gjellë të ngrohtë... por askush s’ia thonte për *“zojë shtëpie...”* dhe, po me short, guzhinjer u caktua Jozef Székely. Székely mblodhi xhaurra, shkarpa a ç’gjeti në për anë të pyellit, kurdisi a *ngrefosi* tre gurë zalli... ndezi zjarrin në mes gurëve... vendoi mbi ’to kazanin me ujë të kthjellët lumi... dhe, prezent në ç’thuhej rrotull zjarrit e kazanit, përziante herë-herë edhe orizin që hodhi në kazan. Qe puna më e keqe që pat kurdisun e bitisun Székely fotograf... ç’sajoi mezi shtyhej... u varguan *nofka e shaka*... por, në fund, një

rremtar me goxha përvojë pune dhe plot mangësi gjuhe... me më shumë fjalë italisht, ca sllavisht e plot xheste shqip... arriti edhe për gjermanikët (!) të qartësoi dhe *fajësoi* orizin... që qe tejngopun me lagështi a njomështi, duke qëndruar përgjatë fundvaporreve diku në ndonjë funddeti.

* * *

Vorbulla më e madhe e rrymës nuk qe në rrugëzimin e ri të Drinit, por nisi në afërsi të Komanit. Në rrëmbim të ujit, togeri fon Shpaun, e ndali udhëtimin. Ngase, nisën vështirësitë e vërteta. Cekej kaskada e ujit, cekej për nja njëqind metra në vijim, vorbulla e rrymës nuk premtonte rehati, do të qe çmenduri mospërfillja... Edhe malësisë tutje Komanit, u tha se nuk mund të ecej me gjithë ato bagazhe. Kështu grupi u nda, ata që qenë përgjegjës për bagazhet u kthyen: Katerajner – me teprina ushqimesh, një marinar, një *kavaz* dhe Dr. Székely – me gjithçka teknike, pra: aparatet dhe kimikatat e rënda fotografike... Ata që u kthyen arritën në Shkodër ende pa u ngrysun. Dhe, të nesërmen, udhëtuan me rrugë toksore për në Prizren. Ku, gjithsesi, sosën *hone* më parë se fon Han-i, togeri fon Shpaun, Don Ëngjëlli apo ç’qenë në grupimin e tyre përgjatë kundrarrymës së lumit Drin. Peripecitë që hasën ua shtynë disi kohën e takimit të hamendësuar. Dhe, Han-i, qe përherë i shqetësuar për mbarësinë e Dr. Székely. S’do ta dimë... mbetet brenda Han-it për ç’qe respekti: për Josef Székely (!) si njeri... për titullimin Dr... (!) ngase, nga gëzimi... për një si paqtim të brendshëm, që fotografitë do të sillnin... sepse, po thyenin një tabu... sapo patën nisun edhe ilustrimin e shkrimeve (serioze...), apo kushedi, për ndonjë porosi meraku të veçantë... (!?). Gjithsesi, nuk do ta dimë. E vërteta është se, Han-i, edhe pa e thënë, vetiu e shtynte në dukje kujdesjen për Székely... Sapo sosën në “Hani i Sakatit”, albanologu pyeti njëherësh për Doktorin. Dhe, u lumturua, kur mësoi se para tri ditësh kishte fjetun edhe ai këtu. Lugina e Goska-s do të qe tashmë pa siklete për në Prizren dhe kështu mbasi hëngrën mëngjezin, e lanë “Hanin e Sakatit” dhe u nisën edhe ata për në *qytetin më të madh të Shqipërisë*... Kur fon Han-i me ç’e shoqëronin arritën në Prizren, s’u muer vesh përke qe nderimi më i madh... Drejt Han-it (me grupin) vrapuan hovngutshëm dhe gazçiltër, nja 150 kalorës, më autoritarët dhe nga më të shquarit e qytetit. Me në dukje buzëqeshjen pa hile, kapardisun si për festë, patën hipur mbi kuaj shale-zbukuruar, me në krye *gjokun* e Dr. Petelenc. Edhe për Dr. fon Petelenc, Han-i, u gëzua. Qe mik respekti për Han-in edhe burri fort i namshëm në Prizren, agjenti konsullor i perandorisë Austro-Hungareze. Gjithsesi, përçka pa asoçastesh mes kalorsve, Georg fon Han-i tha i lumturuar: *“... ne patëm kënaqësinë të përshëndesnim edhe zotin Dr. Székely, që gëzonte shëndet të plotë.”*

Qe messhtatori kur u puqën. U rrëfyan për ç’u pat ndodhun, u kënaqën dhe ngopën me ç’u ofroi shtëpia dhe bujaria e fon Petelenc, punuan me mbarësi nja dy a tri ditë dhe, në mbasditen e së ejtes dt. 17.09.1863, u larguan për në Lumë e më tutje: në luginën e Drinit të Zi, vijuan mbi faqen shkëmbore përbrinjë rrjedhës së shtratit të thellë që, pa hiç gjëkundi urës dhe këmbë ure, quhej *“Ura e Djallit...”* Fjetën dhe gdhinë në një kullë të braktisun në Bicaj, të shtunën, me dt. 19.09.1863, dhe mbërritën në Lusen e Bushtricë, sosën në Radomirë dhe, në fund të atij zgjatimi, u shtruan më ngeshëm në Dibër, ku, Dr. Székely, siguroi edhe tri fotografi. Patën hipur mbi nja 12 kuaj të rizgjedhun, qenë veçantë kuajt për ngarkesat apo dy xhandarët që, për siguri, i shoqëruan misionarët hap më hap.

Gjithsesi, nuk qenë larguar nga Prizreni pa siguruar, së paku, nja pesë fotografi të vlershme...

* * *


Kështu. Në aqsa ditë stivon një muaj, Jozef Székely, bëri vetëm 20 (18 të mira...) fotografi. Lexonjësi i sotëm do të habitej me ballancën 20 (18) foto në 30 ditë. Do t’i dukej çudi edhe një fotografi që nuk e njih historinë e evolucionit fotografik. Për kohën kur bëhet fjalë, madje edhe krejt mbetjen e shek. XIX, fotografimi nuk qe punë e lehtë... As nuk bëhej nga kushdo. Asohere punohej me metodën *kolodio e lagësht*. Edhe Jozef Székely punonte me metodën *kolodio e lagësht*... Që, do të thotë: themeli kimikat i formimit të figurës negative, *kripërat e argjendit*, hapërdahen dhe thithen në suportin e xhamtë, vetëm nëpërmjet eterit alkoolik ku është shkrirë pudër e pambuktë. Shkrirja kimikate e lagësht hapërndahet në mënyrë artizanale, natyrisht jo pa mjeshtri të mësuar. Në njërën faqe të lëmimit të xhamtë hapërndahet emulsioni, vetkuptohet kjo, kujdesshëm kështu. Dhe, ngjitet pashqitshëm aty. Në pritje të bombardimit të dritës që alarmon kripërat e bromurit të argjendit. Nuk do të qe e tepërt të shtojmë edhe diçka mbi themelin e kësaj mrekullie që shekujt e fshehën përgjatë nën xhuben e sekretit... Kripërat alkaline (bromur, jodur ose klorur potasi) në masën 20%, përzihen në nitrat argjendi dhe formojnë një solucion përkatës me kristale që fshihen në padukje brenda tretësinës së shtrirë në mbajtësin (suportin) e xhamtë ose celuloid. Pjesët e shndritshme të objektit pozant që përplasen në pllakën emulsive brenda territ të fotoapararit, rrisin lëvizjen e elektroneve dhe grupojnë në kristal *“grupëzat e thella...”* Krijohen kështu qendra negative që tërheqin jonet pozitive të argjendit (Ag-). Bërthama e vogël që formohet, e ngjeshun mes dhjetra atomesh, krijon bazën e *farëzave* të fotografisë. Brenda emulsionit krijohet qendra e ndjeshmërisë, pikëlimi embrion farëzues... për sajësën e figurës fotografike. Bombardimi i dritës pra alarmon, lëviz e përshpejton... formon – edhepse ende të fshehun – shembëllimin e figurës negative... Tretësira të tjera të posaçme, po aq komplekse, e *çvarrosin negativitetin*... e bëjnë të dukshme figurën (pamja pozitive) e trimërojnë trimëreshë jetëgjatë përballë ndriçimit. Pat lindun fotografia kështu, që, sa t’i sojohet emri (mbas: daguerrotipia... talbotipia... kaliotipia... a ç’hamendësohej...?) u desh edhe kohë. Gjithsesi, Jozef Székely, e nisi punësimin këtu kur emërtimi qe vulosun: fotografia... (foto = dritë, grafi = me shkruar), siç vijonte si për inerci me emërtime që ende i pillte greqishtja...

Sikur qe e nevojshme të thuhet këto, veçanërisht për të theksuar vështirësitë e fillesave fotografike. Edhe sepse, përgjatë kohëfotografimit, gjithçka përgatitej aty për aty, me punë artizanale dhe, jo nga kushdo, veçse nga mjeshtria e vetë fotografit. Veçanërisht deri në procesin *kolodio e lagësht*. Kolodio... i Arshesë-proçes që parësonte edhe në vitet 1870. Ku, përgatitej e përshpejtohej shkrehja e fotoaparitit për ekspozimin e figurës në kushte terrësimi dhe ende pa u tharë tretësira. Vërtetë përshpejtimi i kohës së ekspozimit apo formimit të figurës negative me metodën *kolodio* u arrit disi kënaqshëm, aqsa nuk e lodhte dhe as s’e bezdiste si, dikur, portretin pozant... Por, përgatitjet dhe angazhetë e gjithësishtme të fotografit, kërkonin ende shumë kohë. Mbeti i befasuara dhe i habitun Georg fon Han-i kur vu re me nge se ç’bënte Dr. Székely. Ndodhi kur, diku pa sosun ende në Kalanë e Dodës, pamja romantike e një masivi shkëmbor, i nxitu të dy që ta fotografonin. Në padurimin e shtuar deri në bezdi, Han-i tha: *“...kaluan dy orë e gjysëm... Pra, fotografia s’u bëka kalimthi, ashtu, duke ecur... Kjo dëshmon se: ose u dashka fotografuar, ose udhëtuar...”*

Gjithsesi, në çdo rast, nuk e prishën terezinë: as Georg fon Han-i, as Jozef Székely. Veçanërisht kur të dy qenë të bindun për ç’ka do të fotografonin. Edhe kësorastesh, Han-i, ia lexonte emocionin Doktorit. Diku tej Vaut të Dejës dhe pranë Komanit, kur sapo hynë përmes të çarës shkëmbore, Dr. Székely, e pa gëzueshëm Han-in dhe, duke përkulun kokën e me njërin sy të shkelun, i tha: *“...këtu filllloka davaja...”* Han-i, që e pat vu re edhe në Shkodër ngenë që lypse fotografimi, e la të qetë Dr. Székely. Dhe, vijoi më tutje. Ku, iu shpalos një idil i vërtetë, një mahnitje, një si rryp i ngushtë pranë rrjedhës, rryp toke disi harkor, në formë drapëri, me truma të dendura pemësh, me shtëpi dhe kishë të fshehura nën pemë. Dr. Székely, së paku kësohere, nuk e kishte vështuar dhe ndjesuar kështu bukurinë panoramike. Sikur, qe pa humor. I qe mbaruar *uji i distiluar*... që shplante *të tepërtat emulsive*... mes proçeseve fotografike, i detyruar do të përdorte ujë lumi – hera e parë kështu – dhe, ia vlente të shqetsohej për cilësinë produktive... Kur, fotografi mbas punës dhe shkencëtari mbas mëvetësisë së përsiatjeve... qenë ulun të hanin diçka dhe disi të shplodheshin... në ajrinë dhe *virgjërinë* mahnitëse, këtu, *në qoshen më të humbur të botës*... të dy, edhe Székely edhe Han-i, qenë të mendimit se, gjithsesi, punët e mira bëhen *me mend dhe me nge*...

- Megjithate, qenkemi ngutun diku... tha Han-i – Hiç nuk po më pëlqen, që në ecuninë tande, mungon diçka...

(Vijon numrin tjetër)



Kështjella e Shkodrës dhe Ura e Kirit. Foto J. Székely, gusht 1863.

Fitorja e ngadalshme

poezi nga

SKËNDER RUSI

NETËT E BARDHA RUSE

Mesnatë. Dielli, gati më të ikur,
Për t'u kthyer pas dy orësh
perëndimi!
-Ku e keni natën
o rusë të lajthitur,
T'ju puthim ndonjë ruskë
e mos na shihni!

Të bardha, sarhoshe,
të gjitha këto netë!
Në vdeksh të ngjallka
kjo voddë moskovite!
Ngado që kthej kokën,
më shkel syrin një careshë!
Ngado që hedh këmbët
më zgjatet një shishe...

Mesnatë. Dielli ende s'ka ikur!
Unë kërkoj Esenin
dua ta gjej patjetër (!)
Dhe s'di në pata qenë
edhe vetë i lajthitur,
Apo kështu i lajthitka
Rusia-poetët!?

Balltik, 1994

PADI PËR DETIN EGJE

Në minutën e fundit,
Në orën e fundit në atë plazh
të Kalithea-s,
Në ditën e fundit në atë qytet grek,
Deti më vodhi unazën e martesës!

Kjo ndodhi në thellësitë e tij,
Ku më ftoi për të parë koralet,
Ku më mashtroi me perlat që kish,
Brenda guackave që s'hapeshin fare!

Më futi në kurth, ku më rrethoi me alga,
Më lidhi me gjithë ato fije të padukshme,
Më torturoi me kandilët e neveritshëm,
Ma mbushi gojën me molusqe!

Pa më solli edhe peshq të kuq,
të më hutonte,
(E dinte që isha poet e gënjeshta lehtë!)
Më tregoi edhe peshkaqenët që i rrinin roje,
Dhe më grabiti unazën e martesës!

Vetëm pas kësaj më la të lirë,
Më hoqi prangat dhe unë u ngjita lart!

Më vështronte gishtin bosh edhe qeshte,
Si të ishte një triumfator i madh!

Ai s'ish det,
Ish bastard!

5 nëntor, 2003

REPLACE

Nuk t'i kthej dot ditët
që të kanë ikur,
Sepse jam njeri e nuk jam zot!
Jam si ti, sepse si ti kam lindur,
Jo atje në qiell,
po këtu në tokë!

Nuk mund të jem
njeriu i çuditshëm,
Që ditët e vdekura të t'i ringjall!
Ato ditë as unë nuk e di si ikën,
Asgjë prej tyre nuk munda të mbaj!

Nuk mund të t'i kthej
ato ditë të bukura,
Që një jetë të tërë nuk i harron dot!
Do të kemi prapë ditë me të puthura,
Që unë do të nis të t'i jap që sot!

Nuk t'i kthej dot ditët
që të kanë ikur,

Do të kesh të tjera prej meje,
ta dish!
Unë po të them që në tokë kam lindur,
Paçka se në qiell hyj e dal vazhdimisht!

1 qershor 2011

NJË LUMË I KEQ

Ndonjëherë më merr trishtimi me vete,
Ai është ky lumë
ku rri e zhytur mbrëmja!
Në ujërat e tij është mbytur mëngjesi,
Është mbytur mesdita (imja, jo tëndja!)

Gjithnjë i jam shmangur
këtij lumi të keq,
Nëpër ujërat e tij kurrë nuk jam futur!
Këdo që është i dobët ai e rrëmben,
E sidomos kur të sheh
që s'je i lumtur!

Ndonjëherë më merr trishtimi me vete,
Ai më mban peng pa patur asnjë shkak!
Çdo lumë është i rrezikshëm
kur nga shtrati del,
Po më i rrezikshëm është ky,
që s'ka asnjë shtrat!

31 maj 2011

KUR MUNGON TI

Nga dhjetëra vajza që shkojnë rrugës,
Unë të krijoj ty në ecje.
Njëres i marr sytë,
Një tjetre buzët,
Mënyrën se si qesh ia marr një tjetre.

Bashkoj këto dhe plot të tjera,
Po prapë s'shoh aq ngajshmëri.
Mungon ajo që me sy s'duket,
Që rri e fshehur veç, tek ti!



Seç ke një dritë brenda natës,
Që rri e ndezur dhe nuk shuhet.
Si një piktor përdora ngjyrat,
Por prapë larg asaj që duhet!

Me shpirtin,
Thashë,
S'mund të luhet!

12 qershor 2009



RRITJE

-për time bijë, Nadjan-

Çdo ditë rritet
e sikur më largohet,
Siç largohen shumë gjëra
që s'kthehen më prapë!
Nuk e nxë më divani
ku fle që të çlodhet,
I duhet blerë një i ri,
gjumit të saj!

Nuk di se kur do dalë
nga kjo moshë,
Seç ka një ngut
që ecën nxituar!
Tani nuk e nxë
as dhoma e saj e vogël,
-Duhet blerë shtëpi tjetër,
-i them gruas.

Ndodh që edhe vonohet
ndonjëherë,
Nuk e nxë më nata,
është e shkurtër.
Por, ah, veç natë tjetër
ne nuk mund të blejmë,
Sikur edhe perënditë
të na japin urdhër!

24 korrik 2009



FITORJA E NGADALSHME

Hyra prapë në sytë e tu jeshilë,
Në bebëzat e tyre
zura prapë vend.
Më pas trokita në shtëpinë e shpirtit,
Ku ca të tjerë
prisnin prillin tënd.

Dhe m'u duk vetja
sikur isha një Odise,
Ndërsa ti, Penelopa e famshme.
Të pata pushtuar një herë
kur ishe e re,
Por nuk mburrem
me pushtimet e mëparshme.

Eh,
Zgjasin më shumë
Fitoret e ngadalshme.

25 shtator 2009



DIKUR MË NDODHTE SHPESH

I bëja natës ftesë, për një kafe,
Se më pëlqente,
por edhe më duhej!
Në ora një, kur gjumi sytë hapte,
Përballë meje, ajo vinte, ulej!

Vetëm flokët i kishte prej nate,
Se trupi, krejt, asaj i farfurinte!
Sa herë e prekja, për çudi, me zjarrthe,
Më mbushej prej asaj dhe dora ime!

Nuk di pse ty, ajo, aq shumë të ngjante,
Ty, që prej meje, tashmë, ishe e ikur!
Ajo si ti lexonte dhe filxhanet,
Si ti, me gjarpërinj, më shihte lidhur!

Dhe veç kur dita ishte shumë afër,
Ikte prej meje, ikte, zhdukej fare!
Unë s'di të ngrihem
si somnambul, natën,
Por di që ende kam, në duar zjarre!

Dhe e di mirë që ende s'kam lajthitur,
Si mund të flas me netët
që shpirt s'kanë?!
Por ende nuk e di pse pranë shtratit,
Sa zgjohem nuk gjej një,
por dy filxhanë!

6 nëntor 2003



KUR VDIQA UNË

Më hodhët dhë sa mundët,
Më ngjeshët,
Më vutë një mal përsipër!

Më pas ca lotë,
Më pas ca lule artificiale,
Më pas, më latë e ikët!

Më pas i latë duart,
(nga dheu
edhe nga unë!)
Dhe shkuat,
Drekuat(!)

Dhe nisët
Të qeshni përsëri,
Të thoni barcoleta banale,
T'i shkelnj syrin njëri-tjetrit
Me djallëzi!

Ç'aktorë horrorë!
Në tërë këtë lojë
Me gjoja dashuri!

Veç nëna,
Eh, nëna!
Hyri fshehtaz atje, brenda,
Si një rreze dielli në dimër!

Për të ndarë me mua,
Gjithë atë mal dheu,
Që më vutë përsipër!

Veç nëna tani,
Me zogjtë e gishtave,
Më çuket si dikur,
Më shpupuris flokët!

M'i thërret
Me emra,
Shokët..

SHËN SKËNDER RUSI I KORÇËS

nga Shpend Sollaku Noé

Pse duhet blerë antologjia e çmuar «Me vete kam gjithnjë një Evë»? Pse duhet pasur në bibliotekën personale? Pse duhet lexuar vazhdimisht? Çfarë mund të bëjë ky poet për ju?

Shumë, shumë. Mundet edhe t'ju ndryshojë jetën.

Nëse poezia është një akt hyjnor, keni lexuar librin e një shenjtori: Shën Skënderi i Korçës. Në altarin e perëndive të artit për dashurinë Ai është patjetër përçori, shenjti kryesor, ikonës së të cilit i janë drejtuar e do t'i drejtohen të dashuruarit dhe gjithë ata që banojnë në trevën e ndjenjave.

Gjeni gjithçka në këto fletë, që nga tiparet fillestare të një vegimi të brishtë në rrëzë të Moravës, deri tek shkrirja e plotë me të përher-shmen, ku vetëm disa vargje vlejnë sa dhjetë «atynë»!

Vargu i tij është serum për shpirtra në agoni, ku edhe ai vetë është *kryq dhe i kryqëzuar*, ku ti si lexues je pjesë e asaj lëngate, ku të duket se ato fjalë i ke shkruar ti, ku je edhe qielli, edhe toka, edhe loti, edhe e qeshura e shpërthyer prej syve të këtij *fëmije të marrëzisë*.

Brenda të njëjtës poezi Shën Rusi është edhe klithmë e mprehtë dhe përqafim i heshtur. Tek ai dashuria është totale, mbitokësore dhe e nëndheshme: ajo është dashuri për jetën dhe vdekjen; është *hingëlllima e një kali që krijon ylberët*, është fjetja në një shtrat *me motrën e diellit*, atje ku *tradhtonin si të ishin Eseninë*, ku të vdekurit *shkojnë me natën për të fjetur*, duke e lënë jashtë porte, si për t'i thënë që u duhet si uji të gjallëve. Për t'u kthyer sa më shpejt atje, në botën-Korçë të *lindur nga puthjet*.

Pse duhet lexuar patjetër ky libër? Sepse pa të, të gjithë ju do të jeni më të varfër në ndjenja, më të paaftë për të dashuruar.

Sepse këto janë vargje të shkruara edhe për ata që nuk kanë studiuar kurrë teknika e truke të artit të fjalës. Sepse janë të kapshme, me dukje të thjeshta; por është një thjeshtësi e kërkuar, e studiuar dhe njëkohësisht spontane; një thjeshtësi që i jep peshë magjike edhe fjalës më të rëndomtë, asnjëherë banale dhe e përsëritur, që kthehet në shkollë të artit të poetimit. Sepse tek ky shenjt i poezisë dashurore e rëndësishme është jo vetëm ajo që do të thotë, por edhe si do ta shprehë, që të mos e lodhë lexuesin, të mos e detyrojë t'i flakë vargjet në një qoshe. Aq e punuar e peshuar dhe e ekuilibruar është kjo kapshmëri e poezisë, saqë çdo fjalë duket sikur ekziston vetëm brenda vargut të tij. Një varg i kristaltë, ku, nëse heq edhe një rrokje të vetme, gjithçka copëtohet në mijëra thërmija.

Është e tepërt t'ju bëj një listë banale të botimeve të këtij poeti: Ai është ngjizur në shtratin e Muzave, në ditën e festës së tyre madhore. Është e kotë t'ju theksoj se ku ka lindur, atdheu i tij është zjarri i të puthurës. Veç është e domos-doshme t'ju kujtoj se, kur shumëkujt mund edhe t'i jetë zbehur boja e emrit në gjendjen civile, kur t'i jetë sheshuar varri prej errozionit të harresës, Ai – Shën Skënder Rusi i Korçës – do të jetë në limfën e jetëve të ardhshme, si një dehje e këndshme, soundtrack i dashurive të përditshme.

Alza

fragment romani nga

RIGEL RIZAJ

Ndërkohë, në qiej retë patën marrë trajta demash të fryrë në muskuj e deje, e për këtë arsye po ndeshnin brirët ndaj njëri-tjetrit kur, re a dema?, të flurtë, të egër të butë, të bardhë të zinj, bash në një çast, në një të vetëm dhe zor të shpjgueshëm për natyrën kimike të qiejve dhe reve në trajtë demash, dy (re a dema?) syresh u ndeshën, i përpoqën brirët dhe shkëndija që lëshuan u bë rrufe dhe u derdh teposhtë, çau qiejt për të zbritur në dhë por, medet hej!, në vend që të shkarkohej aty, shkoi dhe çau dhe hyri dhe përcëlloi dhe shumë e shumë gjëra që ne s'mund t'i përshkruajmë ngase zor t'i ngjasë një qenieje njerëzore, e pra, shkoi dhe çau dhe ra dhe hyri mu në vulvën prej shtaze të lopës së vetme që gjendej në lëndinën e madhe, dhe u zhyt brenda si të mos kish qenë rrufe, por aleti i një demi. Hohoho, u shkrinë gazit gjithë burrat e krahinës; uaaa, u turpëruan gratë e djallëzuara, duke sajuar sojsoje fantazish të marra për net që s'do u mbërrinin kurrë në shtretër. Lopa u shemb përtokë, me barkun kah qiejt. Dhe barku iu fry e iu fry, sa gjymtyrët e humbën kontrollin e nisën të lëvizin poshtë e përpjetë, sa majtas sa djathtas, pa fre, sikur të kishin fituar një mëvetësi prej barkut nga ku qenë ngulur, dhe lopa, që herë fryhej e herë shfryhej e sërish fryhej e shfryhej, që lëshonte prej vrimave tinguj e tinguj e tinguj të mrekullueshëm sa edhe të çuditshëm, s'mund të thuhej se ishte më lopë, por një gajde; dhe s'guxoj të hamendoj kush mund të qe gajdexhiu i saj – rrufeja që i hyri aty ku iu rrëfeva, a ndokush që nuk guxoj t'ia përmend emrin. Veç ta shihnit lopën, çfarë shtaze e mrekullueshme ishte ajo në atë çast dhe sa mallëngjyese ta shihje ashtu përtokë, të shndërruar në një gajde që të gatonte përbrenda një ndjesi të përzishme mallëngjimi dhe tronditjeje. Kështu u ndodh krejt rastësht përpara gjithë kësaj skene Cubi i Thethajve, kur mendoj t'i binte përmes asaj lëndine për të shkuar te Gropat e Çara, dhe u shkri gazit, mandej gazi i tij u shtri si të qe llastik dhe u zgjat e u zgjat, sa çiku në fytyrë e gjithë burrave të krahinës, dhe, ashtu si sëmundjet ngjitëse, iu gatua edhe atyre ky gaz që nuk sosej. “Ku, ku e goditi rrufeja lopën e Gjekës?”, cyste Ag Marria, “Mu në picë he burr!”, ia kthente Cubi i Thethajve. Dhe hahaha-të ia krisnin po aq fort, sa pushkët e tyre maleve. Gjeka, i zoti i lopës, kur e lajmëruan për gjithë sa kish ngjarë, brofi në këmbë dhe tha një lutje nën zë, në fund të saj e pushtoi një tmerr dhe ia dha vrapit si i marrë. Kur mbërriti te lopa (apo gajdja?), i thirri në emër dhe zu t'ia kapte dhe t'ia mbërthente këmbët (apo fyejt?). Lopa u qetësua pas shumë orësh, teksa nata i kish nderë në qiell gjithë çfarë mundej të nderte në një ditë të tillë çudish. Nuk ndihej as fryma e bulkthave, as rrjedha e përrenjve të shumtë asaj krahine, as tingulli i thatë që lëshonin gurët kur diçka u përplasej sipër, as qetësia psherëtitëse që mbart në vetvete nata.

Pas tri javësh, – ndërkohë që fisi i Gurkuqëve ia kish marrë gjakun fisit të Bardhajve duke kthyer kësisoje në vend nderin që u ish nëpërkëmbur e zgjatur si llastik mbathjesh (siç këndonte Rapsodi Pitagora) për katëmbëdhjetë vjet; ndërkohë që Hana, e bukura e krahinës, u gjend duke i çuquritur seksit të ngrefur të Ag Marrisë, gjë kjo që nuk ish parë e dëgjuar, ndaj dhe i ati e ngujoi në kullën andej kah Përroi i Verbën, teksa Ag Marria, me gjithë trupin e tij vigan, ia krisi pushkën mu në zemër të atit të Hanës, ndërkohë që duhej të kish ndodhur krejt e kundërta; dhe kur në krahinë një ditë u duk një mal mu përballë (çka i tronditi burrat e i lemeriti gratë) dhe të nesërmen u zhduk, nuk qe më, a thua ishte një shaka, një tallje, një tmerr; e pra, pas tri javësh, teksa ndodhën kësi ndodhish, – në të gjithë krahinën u përhap lajmi se lopa e Gjekës kish mbet me barrë. Tashmë në krahinë nuk flitej pos për barrën e kësaj lope, veçse

qesëndisë së mëparshme i qe zgjeruar stomaku e mbartte më shumë fjalë e ngjyra përbrenda për t'i nxjerrë jashtë, në ajër, duke u sjellë nëpër veshë e mjekra burrash si këngë e si tym duhani. “Diçka duhet të dalë nga kjo barrë”, e hidhte njëri, “Po çfarë mundet të nxjerrë një barrë e tillë de?”, e priste tjetri, “E çfarë mund të nxirret veçse fishekzjarr mor mik?”, dhe gajasje, “Po po, një shkop fishekzjarri që kam për t'ia ndezë vet fitilin”, dhe zënka se unë dhe jo ti jam në sërën dhe nderën për ta kryer këtë akt e për ta shpërndarë në krahinë këtë kumt, por ja që një fjali e pasuar pas kësaj zënke, “Nga kjo barrë më duket se ka për të dalë fundi ynë”, e thënë butë dhe me një bindje njerëzore aq të patrandur, i vuvitte të gjitha gojët dhe në ajër mbeteshin një grimëherë veç telat e bardhë të tymrave që i kish pjellë duhani e flaka. Burrat vështronin njëri-tjetrin, e pastaj njeriun që e kish nxjerrë këtë fjali, e pastaj sikush merrej me një punë të vetëm të atypëratyshme, trazonte duhanin brenda barkut të llullës si për t'u kujdesur mos fikej, apo ndokush kërkonte të dridhte një cigare të re për ta pasur pa mbaruar ajo që po digjej, e ndokush pyeste a gjendej ndonjë gur pasi i kishin mbetur dy lajthi në xhep. Me fytyrë të trishtë, me rrobe të bardha si ato të një shenjti apo mrekullibërësi, me një mjekër të gjatë ngjyrë hiri po aq sa sytë e mëdhenj, tmerrësisht të mëdhenj e të panatyrshëm për sytë e burrave, njeriu që e tha këtë fjali ishte Pitagora, rapsodi i krahinës. Mund t'i kishte tetëdhjetë vite, po aq sa mund t'i kishte edhe njëqind. Askush s'mundej ta dinte me siguri, as më të motmotshmit ndër pleqtë e krahinës. “Ndoshta Dajna Balsha mundet ta dijë”, i kish pëshpëritur njënatëzaj e shoqja njërit prej burrave të pranishëm në këtë çast rrëfimi. Dajna e Balshajve ishte njëqind e tridhjetë e dy vjeçe dhe padyshim duhej ta dinte pasi kish jetuar më shumë se të gjithë burrat e motmotshëm që kishin jetuar ndonjëherë në krahinë. Pitagora ishte hon e jo njeri. Një hon i thellë e plot me fshehtësi. Thuhej se ish dukur në krahinë andej nga viti 1894, pasi e lidhnin me vrasjen që i qe bërë të gjithë pleqësisë së krahinës brenda



një kulle të re, siç ishte ajo e një të ardhuri prej Francës së largët, dhe që ky i ardhur, emri i të cilit nuk u mbajt mend kurrë ngase brezi i ri i udhëheqësi e fshiu nga çdo kronikë dhe kujtesë e njerëzve, ky i ardhur pra, që të mos e holloj tepër, u kish ngjitur disa prej burrave disa sjellje jo fort të hijshme dhe pjesës tjetër disa gjeste e lëvizje që nuk u janë parë kurrë burrave t'i bëjnë, porse grave e nuseve të tyre. Por disa të tjerë ishin të bindur se kjo ngjarje nuk kish ndodhur kurrë dhe se nuk mund të gjindej assesi te libri i kronikave që ish mbajtur gjer më atë kohë, pasi kjo ndodhi kish qenë jo më shumë sesa pjellë e vetë Pitagorës pas mbërritjes së tij me bujë. Disa ishin më të bindur se ai kish mbërritur fill pas kurorëzimit të mbretit, pak rëndësi ka se cilit syresh, pasi në të gjithë banorët e kësaj krahine gjallonte bindja se mbretërit nuk janë veçse disa lule të veshura me rroba e stolisje dhe s'mund të pritej e të hidhej short tjetër mbi ta veç atij se sa do të zgjatte pa u vyshkur kjo lule e rrallë. Më shumë gjasa kishte që Pitagora të kish mbërritur përpara shtatëdhjetë e tre vitesh, fill kur Dajna e Balshajve mbeti e ve në moshë pesëdhjetë e nëntë vjeçare, pas lëngimesh të forta të të shoqit, lëngime që thuhej se i kishin krisur muret e kullës së vet, ato krisje që mund t'i shohësh edhe sot me sy po të afrohesh pranë gardhikut me dru të kalbët. Pitagora ishte një djalë i hijshëm, shtatlartë, me onde të arta që sikur përpëliteshin dhe i zinin ethet kur binte fryma e qiellit mbi të. Sytë e bruztë dukej se hem tash e hem më pas do t'i derdheshin, sa më shumë të ecte e të hidhej, aq më të shumta ishin këto gjasa, por ujërat e syve nuk derdheshin, as pikonin në lëkurë, vetëm sa anoheshin sa majtas-djathtas, sipas lëvizjes që i jepte trupit apo hapit që i merrnin këmbët. Ditën e parë të ardhjes shkoi e trokiti te porta e Hanit Shurdhë. Tom Shurdha, hanxhiu, ishte një burrë kokëshkretë dhe nuk dëgjonte që prej lindjes, një cen ky që ai vazhdonte ta trashëgonte me nder, ashtu siç e kish trashëguar i ati, mandej i gjyshi, ati i të atit të tij, e sa etër e gjyshër përpara këtij gjyshi të atit. Dhe për një marrëzi të tyre, të gjithë djemtë, këta bijë etër gjyshër shtërgjyshër pafundagjyshër, qe bërë me fjalë të quheshin Tom, vetëm djemtë me këtë emër trashëgonin Hanin Shurdhë dhe punët a borxhet e tij, kështu që nuk dihej se sa dhjetra tomër kishin trashëguar dhe udhëhequr këtë han. Pitagora nuk lëshoi asnjë fjalë, dhe kjo qe aq e pritur për hanxhiun që i dëgjoi të gjitha. Të nesërmen, fill pas zgjimit, Pitagori zbriti të hante dhe në sofrën e shtruar, përpara se t'i përvishet ushqimeve të freskëta që lëshonin një avull të hollë e të drejtë qiri, ai nxori prej xhepit një vegël të çuditshme, trekëndore, prej teneqeje, e me disa shenja të shënuara në anë. E vendoste veglën përsipër çdo ushqimi, të cilit diçka i bënte dhe pastaj e hiqte veçmas. Padyshim që ata pak të pranishëm aty u çuditën dhe përgjigjet i kërkonin te sytë e Tom Shordhës, dhe nuk u desh shumë që gojët e tyre të pranishme ta ndanin këtë ndodhi nëpër veshë të tjerë të papranishëm, të cilët s'ka dyshim se të nesërmen e shndërruan papranishmërinë e tyre në pranishmëri të pashmangshme. Por kjo ndodhi u harrua sapo të nesërmen pas asaj të nesërmeje që u mbërriti asokohe, këto gjeste me veglën mbi ushqimet u përsërit e u përsërit për një dekadë të plotë. Jetonte me çudi, pinte me bollëk dhe nuk dihej nëse kish futur gjë në gojë përgjatë këtyre pesëdhjetë viteve të fundit. Një herë ndodhi që në krahinë kaluan disa të huaj, e ku ta dish prej cilit vend?, dhe atëherë ai zu të rrëfente. Rrëfente dhe zëri i tij ishte si leshi që turrnin gratë. Pas kësaj ai u kuptua se ishte rapsod, se bridhte nëpër vise të largëta, dëgjonte e rrëfente. Rrëfente dhe të dukej sikur prej gojës së tij dilnin kuajt e betejave me sulltanë dhe pashallarë, sikur prej aty ai nderte stofrat e mbretërve persë që dëshironin të flinin mbi kërraba barinjsh për të matur rëndësinë e tyre, sikur prej asaj goje të kuqe, e pas shumë vitesh ngjyrë disi në vjollë, vinte për të rënë jashtë dëbora e carëvve të fisshëm e të tmerrshëm njëherit. Tani këto rrëfime ishin të tjera, më të afërta me të vërtetat përreth kësaj krahine. Edhe kjo frazë, “Nga kjo barrë më duket se ka për të dalë fundi ynë”, e thënë po me atë thjeshtësinë dhe çudinë e dikurshme kur ai diçka u bënte ushqimeve me atë veglën prej teneqeje, dukej si një frazë e afërt me të vërtetat e kësaj krahine. Dukej si e kohës. Por sërish, edhe pse për veshët e tyre nuk cytte kurrfarë kuptimi, kjo frazë, e lëshuar si një shtëllungë tymi, e parëndësishme, pa peshë, diçka u dukej se mbartte në vetvete. “Nga kjo barrë mundet me dalë më e shumta një viç që merr flakë”. “Atëherë lipset të presim”, shtoi Pitagora duke nënqeshur, dhe mustaqet e varura mbi buzë sikur iu zbardhën paksa. Dhe dihet: kur qeshet, mustaqet vërtet zbardhen.

Logu i maceve

katër tregime nga

ESMERALDA SHPATA

EMA NUK I BINDET MË AUTORIT

Ema hodhi shallin mbi supe dhe nxitoi nëpër natën e sertë e të errët, të pistë, siç janë këto netët tona. Nuk iu bind vullnetit të krijuesit të saj. Floberi ia bleu dhe helmin, ia shtoi edhe më shumë tensionin për të kryer vetëvrasjen, solli dhe njerëz të tjerë për të qenë prezentë në agoninë e saj të merituar.

Ajo u shkëput si me flatra nga bovarizmi dhe ia dha një piskame çmeritëse sa i futi frikën provincës ku jetonte. Iku nëpër terr sapo shpëtoi nga burri e dashnorët e saj njerëzorë e të paditur. Sharli i dhimbsej bashkë me rendigotën¹ e vet, por, ashtu lëmsh siç ishte, i braktisi të dy.

Ecimjaft, aq samëngjesinuke gjetim në ëndërrime, as e përplasi në tokë të zhgënjyer e të gunjësuar. Ndaloj në një qytet të vogël, larg tradhtive e vdekjes dhe vendosi të hapte një shkollë vashash të zhgënjyera. Fillimisht hasi vështirësitë e pushtetit vendor (ishte shkruar në pasaportë: “Gjeneraliteti - e përdalë”), por gratë e burrave të tanishëm e nuhasnin frikën, ndaj e mbështetën me shpirt. Ato kuptonin dashuritë e tyre të vogla e të mëdha dhe u kthyen në një masë të madhe femërore. Nuk protestuan në rrugë, nuk u futën në greva, siç bënë për votën, por iu bashkuan Emës.

U gjet godina, u mblodhën vlerat monetare, u shpërndanë posterat, u bë gjithçka gati, si nëpër filma.

Ema nuk mbajti lista emërore, nuk bëri renditje alfabetike, shkolla u mbush me femra moshë e pa moshë, aq sa filloi dhe aplikimi virtual.

Nuk vdiq Ema. As se dashuroi, as se tradhtoi fort, e gjeti forcën për ta organizuar jetën dhe pa meshkuj. Kur e pa si veproji personazhi i tij, Floberi i kërkoi gjykatës dënim kapital për vete, madje nuk ishte më i pandehuri, por prokurori i çështjes.

Gjykata u tregua pragmatiste, iu druajt gjyqit të artit dhe Floberit i dha lirinë me kusht: Ta falte Emën që nuk vdiq dhe iku.

P.s. Nuk do të kisha guxim budallai të matesha me Floberin, jo, por si ai që mori shkas nga një gazetë lokale, edhe unë...



PËR HERË TË PARË

Qyteti im më nxori jashtë. Më tërhoqi zvarrë deri te stacioni i vjetër i trenave. U mblodhën shumë njerëz, i gjithë qyteti. Pleqtë çanin mes rrudhave të tyre për të parë se si më mbetej lëkura guriçkave, më mbulonte gjaku, më nxinin gungat nëpër trup. Fëmijët dilnin vullnetarë, më gjuanin me gurë, më kapnin për flokësh dhe fshinin me duar llumin e djersëve që u rrëshqiste mbi fytyrat e ndezura. Skërmiteshin me dhembët e bardhë kur qëllonte që çizmjia mbi bark ishte e njërit prej prindërve të tyre. Një orgji e çmendur shqyente copat e mia me një mllef të patreguar ndonjëherë. E gjithë arsyeja e prapë e botës i kishte hyrë brenda ndëshkimit tim.

1 pallto e lidhur në pjesën e përparme

Nata sikur i bindi, u ngjasoi me vdekjen time dhe u kthyen nga erdhën, me duar e zemra të ngopura. Vdekjes i isha dhimbsur dhe m'i kishte fashitur dhimbjet. Ajo dhe errësira e ftohtë më përmendën. Kisha rënë pa ndjenja mbi ujërat e mia të përziera me të vjella të holla. Nata kishte rënë mbi mua dhe mbi binarët bosh. Qyteti ishte tërhequr në shtëpitë e tij të vogla, në ato të ngushtat, që të lënë pa frymë. Askush nuk u kujtua më për mua, as tri ditët e çudisë nuk m'i dhanë. Hoqën nga vetja mendimin për të kuptuar pse ndodhi kjo. Jam kthyer në një kutërbim të rëndë dhe pres dritat që do të vijnë nga larg për të më çuar më larg. Unë pres uturimën e trenit që do të vijë. Ka më shumë se shekuj, që atëherë kur hekurudhat lidhën botën anembanë, që kërkon të vijë. Thonë se, po të rrish te stacioni nëpër agime, treni mund të kalojë ndonjëherë. Kalova ditë, muaj, vite, kohë, sa shumë kohë. Qytetin gati e harrova, e harrova të gjithë turmën që më dëboi. As turma nuk kishte kujtesë. Unë isha asgjësuar, isha fshirë. Fati kalon agimeve. Një agim m'i solli dritat, sirenën ia ndjeva së largu dhe brofa. Nuk kisha më zemër të më rrihte, nuk më kishte mbetur asgjë nga trupi. Shpirtin ia kisha shkullur me forcë, e kisha çliruar nga njerëzit dhe nga mishi, ai priste mbi ajër. Në atë stacion të vjetër sa bota u dëgjua, për herë të parë, një bori që mori me vete një shpirt. E shpëtova, e nxora jashtë kohe.



LOGU I MACEVE

Një mbrëmje pranvere, nga ato të ngopura me shirat e prillit, më ka mbetur në mendje. Toma, djali i vogël i këpucarit, jo më shumë se gjashtë a shtatë vjeç, iu qep me një shkop Molit, maces së fqinjës sonë. E ndiqte pas dhe i gjuante pa mëshirë. Ai ndiqte macen, të gjithë ndiqnin Tomën. Asnjëherë nuk arrita ta kuptoj tërbimin e tij kundër Molit, mjaullimat e së cilës i shumonte shkëmbi që ndodhej afër shtëpisë sonë. Në fakt, shtëpia ishte ndërtuar afër shkëmbit. Në sinkroni me vuajtjet e saj, me të qarat e çjerra nga dhimbjet, ulërinin qindra zëra macesh. Doja të dilja nga ajo gjendje frike që më mbërtheu. Dyshimi për ta parë të vdekur atë gjallesë të gjorë gati po më mbyste. Sot duhet të jetë bërë burrë Toma dhe, bashkë me jetën e tij, e ka shoqëruar dhe meraku im për fatin. Molin e gjetën të lidhur me kokë poshtë, të masakruar e të nxirë nga goditjet vdekjeprurëse, te sheshi i madh nën hijen e arrës. E keqja më e madhe që i ndodhi atij vendi, ishte vrasja e Molit.

Toma vret çdo ditë mace në ëndrrat e mia, ato mjaullijnë të izoluara mes shkëmbit. Unë çukis nga pak ushqim si për të mbajtur shpirtin gjallë, për ta kaluar veten nga nata në natë e për të dëgjuar të qarat në ëndrra. Madje tani kam krijuar bindjen se nuk mund ta lë të më ikë nga duart kjo temë.

Ç'vjen më pas, është nëma e të ndjerit.

Ajo jehonë e përzishme macesh i ka mbytur të gjitha zërat në një llurbë fati. Edhe mua, që isha një çupkë e vogël fshati, më kap dufi dhe shfryj pas

ëndrrash fshehurazi e në heshtje.

Sapo dëgjoj një ngjarje, a një fat absurd prej Moli në ulërimën time prej maceje atje te logu mes shkëmbit.

TREGIM ME HYRJE

Shkundi lehtas kokën mbi supet e drejta dhe qafën e gjatë. Përthithi me vështrime gjithë panoramën e pamatë të qiellit në atë orë të bruztë të mbrëmjes. Mori frymë thellë me të gjitha shqisat ngrehur, admiroi hapësirën dhe përmbushi kënaqësinë e të qenit.

Sfondi i kësaj skene nuk mund të ishte ndryshe.

Në verandën e madhe të zbukuruar me jargavanë të shtëpisë me çati të kuqe, bri rrugës, ndodhej një tavolinë e mbuluar me xham të gjelbër.

A mundet ta shohë një mjellmë qafëgjatë një gotë kristali të krisur mbi tavolinën me xham të gjelbër te veranda e madhe e shtëpisë me çati të kuqe?!

Atë mbrëmje, shtëpia nuk kishte brenda asnjë krijesë të ndrojtur.

Burri flinte në verandë mbi pllakat e bardha, pa jastëk, i shtritur deri në parametrat më ekstremë të trupit të vet. Gjethet e lara të blirit i bënin hije dhe fresk duhmës së verës së kuqe. Mjellma shikonte burrin të cilit gjumi i thellë nuk ia fshihte dot fshehtësinë e shpirtit. Se si ra në gjurmët e tij ajo krijesë e bardhë, askujt nuk i interesonte. Tingujt pluskues që dilnin nga brendia, jo të gjithë shprehnin mungesë lumturie, ndihmoheshin nga shishja e zbrazur e verës.

Burri flinte. Sytë e tij të mbyllur fshihnin kuptimin e jetës. Ajo çfarë shihej nga jashtë, ishte pamja e tij dehur. Ishte zbathur. Dukej sikur tërë jetën e tij kishte ecur zbathur. Nuk dukej shenjë këpuce në këmbët e tij mbushur me flluska.

Nuk ishte e qartë nëse hija që i binte mbi fytyrë, mund të ishte e blirit. Ajo mund të ishte e shkuara e tij. Nuk dukej t'i kishte mbetur gjë. Përfund të linjtave nuk kishte më asnjë detyrim burrash.

në studion e tij të madhe, përballë bibliotekës, në pikturën e varur në mur, mjellma shikonte burrin e njëmendët, burrin që gërhiste në dyshemenë e verandës së shtëpisë me çati të kuqe, të shtëpisë që kushedi ku ndodhej.



Një verë me Lasgushin

tregim nga

ALEKO LIKAJ



Ai qëndronte përtej i heshtur me fytyrë nga liqeni. Dukej i Apakët nga trupi që kishte filluar të kërusej, ndërsa supet, i vareshin poshtë si të lodhura. Ndoshta nga pesha e viteve. Ca leshra të bardhë që dilnin poshtë borsalinos verore, lëviznin nga një puhizë e lehtë që vinte nga larg, e vëndi i huaj, përballë, i cili tretej si një konfiguracion i çuditshëm në një breg, që herë-herë, ngjasonte me një vetull të hollë femre, e pastaj përcudnohej nga avujt e nxehtë. Poshtë tek këmbët, një qenush i vogël bënte rradhë, duke lëvizur i shqetësuar, sikur të kërkonte diçka nga i zoti, që vështronte pejsazhin në atë hapsirë kaltërsie. Ne qëndronim vetëm katër hapa, më brenda verandës së hotel Turizmit të vjetër, të atij qyteti. Kishim zënë vënd qetësisht për tu drekuar, pas atij udhëtimit, që kishte nisur që para katër orësh nga Cërriku. Plaku në fillim, na hodhi një vështrim, pasi i tërhoqi vëmëndjen zhurma që i shkaktuan karriket tona, kur i lëvizëm nga tryeza e ngrënies, e pastaj qetësisht, ishte kthyer ashtu si më parë, përballë me liqenin

Ka qenë verë e tej nxehtë korriku. Nuk e mbaj mend, në se ishte në fund, apo në mes, por ajo verë ka qenë disi e veçantë, pasi ato ditë, temperaturat në shkallë vendi, shënuan edhe një rekord të ri. Isha mësues ato kohë, në fshatrat e Dumresë, e pushimet e sapo marra, i kaloja me miqtë e shokët e brezit tim cërrikas, në Shkumbin. Mernim me vehte bukë, e rrinim nën hijet e shelgjeve. Herë pas herë freskoheshim në ujë, në dy pellgje, që nuk i kalonin as edhe dy metro thellësi

Tre ditë më parë, kisha marrë një ftesë nga Vasil Qerfozi, për ta shoqëruar deri në Korçë. Ishte shofer, dhe me “zis-in” e tij, udhëtonte për llogari të konsumit të Cërrikut, për të sjellë herë pas here, birrë “Korça”. Nuk ishim moshatarë. Duhej që të ishte gjashtë a shtatë vjet më i madh, por ajo që na bashkonte, kishte të bënte me librat. Lexonte shumë Vasili në atë qytet, dhe, zor se i kishte shpëtuar libër, që delte asaj kohe. Në shtëpi mbante edhe një bibliotekë me libra të rrallë. Një muaj më parë më kishte dhënë Remarkun, “Tre shokët”. Nuk kishte mbaruar as edhe shkollën e mesme. Jetim ishte rritur, pa baba. Nëna e tij, Aspasia, punonte si rrobalarëse në hotelin e beqarëve të rafinerisë së naftës. Më t’për se sa ti bëje shoqëri përgjatë asaj rruge, më kishte ftuar për të diskutuar për “Tre shokët”. I pëlqente mjaft ai libër. Edhe skenat i kujtonte, sikur ti kishte përjetuar vetë. Ashtu bë më, deri sa mbritëm në Pogradec, në mesditë. Me ç’monte si një mik. Atë periudhë, kisha nisur që të botoja në shtypin letrar të kohës, madje në shtëpinë botuese, kisha dërguar edhe vëllimin e parë me poezi. “Njerëz dhe kaltërsi” e kisha titulluar. Histori tjetër kjo e vëllimit, që desh, e më hëngri kokën. Por për Vasilin, do të thoshte, se po udhëtonte me një “poet”. Kështu më thërriste... vazhdimisht, edhe në hapsirat e asaj kabinë zis – i, sa herë që kërkonte që ta merrte fjalën. “Dëgjo këtu, poet...”. Vihesha në një lloj sikleti, por serioziteti i tij, që dukej se më drejtohej pa të keq, më bënte që të mos reagoja, ndonëse, ndjeja se fytyra më përsikuqe, jo nga ndroja.

Kamarieri, një gjatovinë, me flokët e qethur shkurt, e me një hundë të hollë, ku maja i ngrihej paksa përpjetë, mori porosinë, e na la sërish në diskutimin e librit të Remarkut. Në nuk e kishim më mëndjen tek plaku, që dukej atje përtej, si një statujë e heshtur, dhe i latuar nga një dorë mjeshtri në skulpturë. Zhaurima e valëzave në breg vinte e dobët, dhe here-here, dukej si një melodi, në një sfond me hapsirë krejtësisht të kaltërt.

Ule zërin – i thashë Qerfozit, që bubullonte si në një qiell, pa një re, dhe bëra me kokë nga soditësi i liqenit.

Tjetri heshti për një çast. Kthehu kokën pas, e u duk, se picëroi sytë gështenjë.

- Ke të drejtë. Mbase, vërtetë e tepruam, paksa. Po ç’ti bësh Remarkut?- u justifikua bashkbiseduesi ynë. Ndonëse këtë herë e kishte ulur zërin, ndjeja se një zë, si fëshfërimë, i pakuptimtë për mua, sikur përtypte fjalë dhe gërma në një gjuhë krejtësisht të panjohur, nga ana ime, më tundoi në çast. Ishte një frazë që kishte brenda saj, diçka si thyerje, e që dukej se të vriste paksa veshin. Si një monolog, që interpretohej me fuqinë e një aktori potencial të skenës.

Vasili vuri buzën në gaz, e tha një frazë në të njëjtën gjuhë. Soditësi tashmë ishte pranë nesh. Nëpër këmbë i ngatërrohej

qenushi, që më tepër, se sa lëshonte disa tinguj të lehtë, me një “gërrr” të zgjatur hundore,dukej se kërkonte diçka poshtë, pranë këpucëve të të zot .

-Qenke i kënduar – tha Vasili, njeriut që nuk ishte veçse një hap larg nesh, me një këmbë në rrugicën e betontë, dhe tjetrën, në barin gjysëm të tharë, nga nxehtësia e asaj vere.- Remarkun e ligjëron në gjuhën e nënës së tij. Tjetri lëshoi një klithmë, me një shfryrje të kraharorit, dhe zuri vënd, në një karrike të tavolinës përballë. Dukej se kishte diçka fisnike në atë lëvizje , që kur zuri të largojë karriken, e pastaj, kaloi këmbën e djathtë midis tavolinës,dhe vëndit që do të ulej një çast më pas, në atë masë të padukshme ajri, sikur kërkonte të mos lëndonte asgjë .

- Më thatë në gjuhën e Remarkut, që morali është i pari, të tjerat vinë pas- tha njeriu që hyri në bisedë midis nesh. Lëvizi kokën, pastaj, duke e shkëputur vështrimin për të na fshehur sytë e vegjël, që kalonin nga një gri e thellë në të errët, deri në një të zezë që shkëlqente.U kthye nga qenushi, që i thirri ëmbël, “cuci”, dhe, që i kishte vendosur dy këmbët e para të zot, në prehër

- Ah, të më ndjeni. Unë nuk di gjermanisht. Ishte një shprehje, që e kam marrë tek filmi “Principi i moralit të lartë”. Natyrisht, që i a di kuptimin, por, që më pëlqen ta them vazhdimisht. Unë filmat i shoh disa herë, po ashtu edhe leximeve, i kthehem me kënaqsi.

Plaku nuk foli.Vendosi dy duart mbi mbulesën e kuqe dhe me vija katrorësh të bardha të tavolinës.Vuri buzën në gaz.

-Endërojmë, sepse pa endërrat, nuk do të mund ta duronim të vërtetën. Njeriu nuk gënjehet vetëm nga endërrat. Njeriu gënjehet edhe me të vërtetën. Kjo është një ëndër akoma më e rrezikshme... - përsëriti plaku para nesh, atë që me sa dukej, kishte shqiptuar në gjuhën gjermane.

- Janë fjalët e Remarkut në gojën e Patit – reagoi menjëherë Qerfozi, ku dukej një lloj krenarie, dhe triumfi së bashku. E shihja që gëzohej si një fëmijë

Bashkbiseduesi i Vasilit, u kthye nga qenushi;

-Prit, prit. Sa i padurueshëm që je. Duhet të kuptosh, e të sillesh mirë, sa herë, që ne flasim me miq, e të sapo njohur këtu në Poradecin tonë.

Por qeni si qeni. Edhe pse e shikoi drejtë e në sy të zot, si një njeri i vërtetë, zor se kuptoi, nga të gjitha ato që i tha plaku i atij qyteti. Ky, që u koll në çast, duke vënë grushtin përpara gojës, nxori pastaj, nga xhepi i pantallonave të gjëra, që nuk mund t’i a dalloje ngjyrën e vërtetë, një shami të mbledhur. E vendosi në tavolinë, dhe pastaj e hapi ngadalë. Ishte një vezë e zier dhe e qërruar më parë. Qenushi lehu tre herë, dhe duke tundur bishtin, angulli u lehtë.

Nuk e do këtu?..Eh!,për këtë, gjithëçkah hahet në shtëpi – tha për ne njeriu i tavolinës përballë. Pastaj i u drejtua qenushit, që vazhdonte ta shihte drejt e në sy, si një mik zëmre i vjetër. - Mirë, mirë. E mora vesh. Po shkojmë ngadalë...

U ngrit nga tavolina duke krijuar një zhurmë, nga tërheqia e karrike, e na salutoi plot hijeshi.

-Drekë të mirë.-

Zbriti shkallët me një hap të ngadalë, e pastaj doli në rrugë.

Qeni i u vu nga pas.Vasili, që e ndiqte këtë skenë, u kthye nga unë. Më hodhi një vështrim te ëmbël, e tha ngadalë, “burrë i gjesdisur”

Një çast më pas, kamarieri solli porosinë, dhe pjatat, i vendosi mbi mbulesë, duke na shërbyer, si në një lokal të vërtetë turistik.

-Ç’u tha poeti, mo-o

-Cili poet – pyeta unë, pa menduar, se ne, sapo ishim ndarë nga një njeri, që e gjetëm në atë ambjent.

Vasili ishte bere kurioz.

- Lasgushi, mo-o. Ai plaku që gjetët këtu. Vjen çdo ditë e çlodhet

Nuk po e merrnim vehten. Qerfozi përplasi dorën e djathtë, lehtë mbi tavolinë, e tha ;

- Ky ishte, Lasgush Poradeci?

Tjetri vuri buzën në gaz, duke na parë, se si reaguam në atë çast.

- Jeton në Tiranë, por verërat i kalon, ja këtu në Poradecin tonë. Ikën në vjeshtë, kur emigrojnë shpezët e ajrit.

Kaq u desh. Kamarieri tashmë, na kishte lënë vetëm aty në

tavolinë, përpara pjatave të mbushura me peshk e sallatë. Na u duk, se kishte shpërthyer diçka mes nesh, diçka që na kishte vrarë, por jo gjakosur. Po dilnim nga një ëndër maramendëse, si të kapitur, e të gjymtuar,të dyzuar deri në karakter. Nuk po besonim më asgjë.Vasili vendosi dy gishtat e dorës së majtë mbi sy. I lëvizi në heshtje përgjatë kokërdhokëve, e pastaj i mbylli qerpikët, sikur të ishte verbuar nga një burim i fuqishëm drite.

-Mbase rrojmë kot në këtë dynja, që po më duket e gënjeshtërt, dhe tepër hileqare.Të flas sinqerisht. Unë Lasgushin e kam ditur të vdekur, dhe të haruar, por ja, që ai na doli gjallë. E kishim, ja këtu, mes nesh, përpara syve tanë...Mos unë jam i lajthitur ?

E ç’mund që ti thoja Qerfozit ëndërimtar. Si në një celuloid filmi, më kaloi një episod i dy viteve të shkuara, kur shkova si mësues letërsie në një fshat, atje në Dumrenë e largët. Me pasionin e një djaloshi të dashuruar marrëzisht pas letërsise, fillova që të ngrejë të parin kabinet të letrave shqipe. Pasi kisha siguruar disa kartona, i ndava ato në katër pjesë. Vendosa që të bëj shkurtimisht jetëshkrimin e autorëve shqiptarë, që ishin në tekstet e leximit letrar të shkollës 8 vjeçare. Munda, që të gjeja edhe nga një foto, të mbledhura nga botimet e tyre. Pastaj, rendita edhe veprat, përpos ditëlindjeve e ditëvdekjeve të tyre. Lasgushin e kisha vendosur tek autorët e viteve 30 të. Kisha shënuar ditëlindjen, por vdekjen jo. Fëmijve u thashë, që kishte vdekur, “aty nga fillimi i viteve 50 të”

Vetëm kaq.

Pastaj, kisha jetuar me këtë frazë të thënë përgjysëm në klasë, pa e ditur, se kisha bërë kështu, budallallëkun më të madh të jetës sime prej mësuesi, dhe letrari.

Por, nuk mund që ti a thoja, që të gjitha këto, Vasilit, i cili, ishte treguar më i sinqertë se sa mua, në atë moment. Bëra sikur e kuptova, dhe i vendosa dorën mbi sup, si për të thënë ; “na ndodh edhe kështu”

Dy jave më vonë, me Vasilin, përsëritëm rrugën për në Korçë. Qëllimi ynë i vëtëm, ishte, që të takonim sërish poetin. Pak ditë më parë, Qerfozi kishte mundur që të bridhte rrugëve të Pogradecit, afër një orë, por nuk e kishte parë, gjëkund, njeriun me qenushin nga pas. Pastaj ishte kthyer buzë një rruge, në një dyqan fruta-perime, për të blerë qershija, që ti kishte për rrugës,sa për të njomur gojën, dhe të pyeste, për njeriun që takuam në Turizmin e vjetër. Këtë herë, Vasili, ishte bere “diplomat”. Ne vënd të emrit, kishte thënë, se kërkonte një të moshuar, me një qen të vogël nga pas. Këtë, e kishte bërë, për ta identifikuar edhe një herë emrin, që na dha kamarieri me hundën që kishte fundin si majë, duke na lënë, jo vetëm të shokuar, për egzistencën e poetit, por edhe të pafjalë.

-Nuk e gjeta – më tha, sapo u kthye në Cërrik. Pastaj,më tregoi gati me një frymë, « odisenë e tij nëpër Poradec », ashtu siç e quante vetë poeti.

Unë duhej që të rija përpara tij, si një guak, pasi ai më hodhi një vështrim të çuditshëm, nga koka deri tek këmbët. Fjalëprerë. Vasili fërkoi shuplakat e mëdha, sikur të fshinte prej tyre, diçka të padukshme e misterioze, duke mos ma ndarë vështrimin e tij, e pastaj, bëri udhë përpara.

-Do ta gjejmë.Do ta gjejmë, që çke me të. Mos më thëncin, Vasil Qerfozi. Do të nisemi përsëri në mes të javës, pasi qyteti ka edhe tre dasma te tjera.

Kjo mjaftonte.

Dy ditë më vonë,ndersa isha kthyer nga Shkumbini, ku isha përcëlluar i tërri në një mënyrë të tillë, që ndjeja dhimbje në të gjithë trupin, Qerfozi, mbriti poshtë ballkonit tim.

-Hajde, se do ta eksplorojmë Poradecin.Do të nisemi pas mesnate. Ngarkojmë në mëngjez tek birra »Korça », dhe pastaj,

kthehemi në Poradec. E kërkojmë. Do të kemi shumë kohë në dipozicion deri në mbrëmje. O e gjejmë,o i themi vehtes sonë, që jemi hiçër.

Vasili,gjithmonë gjërat i merte me pasion. Ishte këmbëngulës, dhe kërkonte që tu shkonte deri në fund. Mbase, kjo ishte në fakt, edhe arsyeja që këtë udhëtim ta merrja, jo më shumë entuziazëm. Qefi ma kishte, që të takoja lirikun, sepse, të vetmen mundësi që pata , e kisha shpërdoruar. Dhe kjo, jo vetëm për fajin tim.

Ishim vënë në udhë. Kishim lënë nga pas Librazhdin. Kuptova që ishim bërë esull. Tashmë gjumi, që na përkundëte pak çaste më parë, ishte larguar. Nata e pranishme nën atë pejsazh, ku dalloheshin siluhatat e majave të masiveve, e ku gjarpëronte rruga, dukej si një mantel i zi i hedhur mbi ne. Në Rajcë qëndruam. Ishte një klub buzë rrugës, nga ata të kooperativës. Mbante era thartirë.

-Kam zënë kosin për në mëngjez – tha bufetieri, një meso burë, me flokët si iriq. Në dhomën e vogël pas banakut, dukej një grua që fshinte herë pas here duart, në përparësen e vendosur përpara. Kafen e pimë shpejt, dhe ajo u duk se na përmbloodhi. Vasili nuk pranoi që ta shoqëronte me alkol, ndonëse ai i shkretë, ishte edhe pika më e dobët e tij, “thembra e Akilit”. Unë i a propozova disa herë, por ai nguli këmbë, se, “jam në makinë”. Pastaj, i u ngjitëm “Qafës se Thanës”. Kur mbritëm ne majë, poshtë liqeni që dremiste, u duk se zbardhëlloi. Përtej, mbas “Malit të Thatë”, dukej se ishte grisur manteli i zi i natës. Një njollë e trëndafiltë, që, zor së mund ta dalloje, nga ato që bëjnë shpesh nxënësit në fletoret e vizatimit, kur kokrizat e lapsit, i shpërndajnë me pambuk, dukej se po merrte hapsirë. Vasili, nxori dorën e djathtë nga dritarje e “zis-it”,sikur, atë skenë, kërkonte që ta vinte në grusht, e në çast, bubulloi.

Fryn veriu ndë Mal të Thatë, thotë vasha lele ngriva Duro vashë, të durojmë, si duron mali deborën... Pastaj, kjo erë e veriut, nxitoi që të vinte vërtetë,në atë kabinë të ftohtë mëngjezi, së bashku me erën e liqenit edhe lirika të tjera të Lasgushit.

-Qyteti po sheh ëndërra – thashë unë, për tu gjetur në bisedë. Kisha heshtur.

-Shyqyr që e the edhe ti një llaf, se, më dukej vehtja i vetëm në këtë kabinë.- Qeshëm.

Kur u shfaqëm në Korçë, “puntori i palodhur i ditës”, u kishte thënë “mirmëngjez” fushave të paana dhe malit të Moravës, që qëndronte përballë nesh, i heshtur, dhe hijerëndë. I pajfalë.

-Do të provojmë paçen dhe kërnackat korçare – bëri humor Vasili, ndërsa parkoi makinën pranë fabrikës.

Ashtu bëmë. Mëngjezin e hëngrëm shpejt dhe u kthyem sërish tek porta e Birrës

-Pse kaq shpejt, moo tu mbylltë, - tha roja, që me sa dukej, njihej mirë me Qerfozin.- Mbetet pa e pirë ju elbasanllinjtë, mo-o.? Këtu e keni, dhe, nuk u a merr njeri. Ju na bëni gjysmën e planit...

Vasili nuk i a kishte ngenë. Futi makinën brenda, dhe, ndali në magazinën kryesore.

-Kam hall, - tha ai- nëna është duke pjellë sërish, dhe unë, nuk mund që të rrij pa asistuar, në daljen në dritë të kolopuçit, që do të na shtoj vatrën familjare.

Shakaja e tij mbante erë një kilometër larg. Puntorët, që sapo kishin vënë këmbën atë mëngjez në ndërmarje, nxituan. Dhjetë minuta më vonë, mbriti furgoni i turizmit të qytetit

-Tëmën-o-o – tha shoferi i tij, një burrë tej i shëndoshë, i qethur ballaboks.-Raqkë-ë-ë, po ky elbasanlliu paska fjetur këtu, ndë Korçë mo-o-o. Përcilleni shpejt se nuk pret puna. Ngeli plani pa realizuar tek ne...

Morrëm kthimin. Këtë herë me diell. Vasili nxitonte. Herë pas here i hidhte një vështrim orës, e pastaj, buzëqeshte si një fëmije i parritur, e çamarok. Pogradecin e gjetëm në mëngjez, të sapo ngritur nga shtrati. Kishte filluar tregu. Ne kaluam mes për mes, dhe u ndodhëm përballë turizmit. Aty ishte edhe shëtitorja e vetme e atij qyteti. Sidoqoftë, menduam, se, nuk ka asnjë pogradecar që të mos kalojë, qoftë edhe një herë i vetëm në ditë, pikërisht në atë shesh. Mirëpo, Vasili, e shfaq i pari shqetësimin e tij.

- Poeti ynë që ka qenë në perëndim, me siguri, që ka marrë edhe huqe të andejme. A e di se ku zgjohen andej?– u kthye nga unë, sikur kërkonte që ti thoja pikërisht, atë që kishte ndër mënd ai vete.

E ç’mund që të bënim, veçse të prisnim? Kështu dhe ndodhi. Të gjitha rrugët na çonin dhe na kthenin në të njëjtin kënd. Kur po thyhej mesdita, dikush na tha, se Poradeci, poeti, kishte kaluar një çast më parë me të bijën, në rrugicën përballë, por që nuk dukej, nga aty ku ishim ne.

Qerfozi këmbëngulte.Kamarieri na mbante me shpresë. Për ta bërë më të besuar, na tha;

- Dje ishin këtu edhe dy poetë nga Tirana. E takuan.. Pinë verë të kuqe këtu tek unë.

- Ç’shans – tha Vasili, që dukej i paduruar.- Kushedi se sa

të lumtur që kanë qenë ata njerëz.Verën ja pinë poetit, këtu në Pogradec, por nuk e bëjnë dot të gjallë. Shurdhmemeccëri.

Mua nuk më mbante vëndi. Ndjeja një pezm brenda vetes sime, dhe çdo çast që kalonte më bënte më shumë mosbesues. Vasilit, nuk mund që ti thoja dot, asnje fjalë. Më dukej se do ti prishja magjinë, me të cilën ai po jetonte gjatë gjithë atyre ditëve. Një orë më parë, kishte dalë në breg të liqenit, dhe kishte lagur sandalet verore në valët e tij. Pastaj kishte rrecituar, “Dremit liqeri” - Ku e ka shtëpinë – pyeti befas ai.

Kamarieri na pa drejt e në sy. Ngriti pastaj supet e rrëzuara, për të thënë “se nuk dinte gje”. Hodhi vështrimin jashtë, përtej shkallëve

- Ja andej, tej – bëri më shumë me kokë, pa përcaktuar asnjë drejtim, dhe pastaj u nis drejt sportelit, ku dallohej kapelia e bardhe e kuzhinjerit.

Hajde ta gjeje. Unë u stepa. Më dukej, se nuk shkonte, kjo gjë. Do të na merrnin, ose për të çmëndur , ose, do të na kujtonin keqbërës, në atë qytet të vogël, ku njerëzit, jo vetëm që e njihnin mirë njeri tjetrin, por më dukej, se njihnin mirë edhe të afërmit e tyre, që vinin verërave për vizita malli. Dhe halle liqeni.

Po Vasili nuk tërhiqej. Mund, që të jepja gjithëçkah në atë çast, vetëm që të lëviznim prej andej. Nuk e di, por qyteti, që kishte lëshuar tashmë hije, po më dukej më i vjetër e arkaik. Lëviza nga liqeni, aty në hyrje të qytetit, dhe zura vënd mbi një gur të madh, buzë gjolit. Përtej,një varkë e thjeshtë, kaloi mes përmes një gjiu të vogël, dhe filloi që të marrë thellësi.për andej nga plazhi, Ca rathë, që hapeshin mbi liqen, vinin e përplaseshin deri tek unë. Një zog i bardhë, erdhi e qëndroi fluturim, mbi sipërfaqen e lëmuar të ujit. Kërkoj, që të fusë sqepin brenda, por në një moment, u duk se u pendua. Mbase, nuk e gjeti atë që kishte menduar pak çaste më parë, kur u shkëput nga pankina e betonte, që zgjatej disa dhjetra metra më tej. Dita kishte filluar që të thyhej, e dielli, nuk digjte më si më parë.

Qerfozi mbriti. - E shoh që u mërzite. Mbase të kam rënduar pak. Kështu jam gatuar unë. Kam pak shpirtin e aventurës. Nuk e kupton, se ai nuk egziston, jo vetëm për ne, por edhe për vetë shtetin. I haruar. Nuk është faji ynë, që Lasgushin e mendonim në një tjetër konstilacion. Të ikur. Do të na duhet që ta ndjekim këtë yll, që ruan ende shkëlqimin e tij.

Në mesnate erdhëm në Cërrik.Të lodhur e të rraskapitur, por të lehtësuar disi shpirtërisht. Nuk ishte faji ynë, që shteti e kishte haruar lirikun shqiptar. Kjo, na përjashtonte disi nga brerja e ndërgjegjes, që poetin, e kishim vendosur me të ikurit, duke e nxjerë jashtë vehtes nga bota jonë reale.

Një mbrëmje më pas, Qerfozi, më gjeti në klubin e qëndrës së qytetit."1 Maji" , Kështu i thonim ne atëherë, për të thënë, se ishte vërtetë një klub i puntorëve, të atij qyteti të vogël naftëtarësh. Isha me tim vëlla, Petritin, e një shokun e tij, mësues fiskulturë. Sapo kishim zënë vëndet në një nga tavolinat e mezit

- A mund që t’u a marr Lekon, për dy minuta? - Mund që të pini edhe ndonjë dhallë, se ky, nuk vë gjë tjetër në gojë – bëri shaka vëllai im, që dinte diçka nga udhëtimet tona në Pogradec.

- Dëgjo këtu, poet. Nesër më duhet që të nisem sërish për birra, në Korçë. Këtë herë, kam menduar, që ti le një takim Lasgushit. Me kamarierin, në të njëjtin vend. E planifkojmë, si sot një javë. Dhe, po nuk u planifikua Korça, do të nisemi drejt e në Pogradec, me zis-in tim. Do marr karburant në uzinë, për këtë rrugë. Eshtë mundësia më e mirë për tu takuar.

Të nesërmen nuk zura gjë me dorë. Lashë edhe Shkumbinin, dhe i vetëm në shtëpi, me dukej vehtja, si në një kafaz të fortë hekuri. Atë ditë qëndrova i mbyllur. Edhe të nesërmen , po ashtu. Në mbrëmjen e ditës së tretë, ndjeva se dikush më thirri në ballkon. Nëna më tha ; se është i biri i Aspasisë, Vasili, I trishtuar, Qerfozi nuk më pa as në sy.

- Ka ndodhur diçka. Më thanë para një ore, që të dorëzoj nesër në mëngjez, zis-in. Nuk di se si ta spjegoj, por më duket, sikur më kanë marrë zemrën, jetën time te vërtetë.

Në fund jave, e pashë të përlotur, andej nga rruga e spitalit. Mbante era alkol. E kthente ndonjëherë, së bashku me librin dhe makinën, ishin pasionet e vetme të këtij njeriu, që fliste, sikur të kishte mbaruar tre universitete.Më erdhi keq në një moment. Vasili e kuptoi.

- Kam folur shumë, poet. Mbase në një vënd ku nuk duhej. Më ka trishtuar Lasgushi, dhe haresa ndaj tij. Këtë, ma tha shefi i degës së transportit, tek ne. Burrë i mirë e me zemër flori. Kishte marrë urdhër për të ma marrë zis-in tim.

Pak ditë më vonë,zis-i i Vasilit ishte në lavazhin e komunales. Shoferi i saj , një meso burrë, nga komuniteti me ngjyrë i qytetit, e pastronte si një nikoqir i vërtetë. Fërshëllente ëmbël një melodi nga të festivalit të fundit. Këngë marsh, që kishte brenda saj “revolucionit marshon”... . Këtë njeri, e kisha parë vazhdimisht në aktivitete e qytetit, e festat, në krah të policisë, për të mbajtur qetësi dhe rend. Mbante nje shirit të kuq në krahun e djathtë, ku shkruhej me shkronja të bardhë “A.G.V”

Që prej asaj dite, midis nesh, nuk folëm më për Lasgushin. Vera po thyhej, dhe vapa ngadalë po i linte vendin një fresku, që frymonte si një qenie e padukshme në qytetin e vogël mes fushës, në krahun e majtë të lumit Shkumbin.

Bordo 13.07.2008



DRAMATIKA E NATYRËS SURREALE

nga Behar Gjoka

(Vijon nga numrin i kaluar)

MIDIS KANUNIT DHE LIGJIT

Drama **Lojë mbasdreke**, mbase teksti më i fuqishëm dramatik që trashëgojmë prej **Camajt**, jo vetëm për shkak të kolizionit të thekur dramatik, por më tepër për arsye të parashtrimeve të qëmtuara të veprimit dhe dialogut të gjetur dhe ironik në një masë të konsiderueshme, vendos në qendër të vetë një konflikt paradoksal, një përplasje mjaft të hershme, por që megjithatë rrezaton edhe sot e gjithë ditën, por në skenë më shumë shpërfqen hijezime të prekshe të natyrës vrastare të gjakmarrjes, edhe në këtë shekullin e ri. Thelbi i konfliktit dramatik të kësaj drame me nuanca të dukshme tragjike dhe komike, pra më tepër të një tekstit tragjikomik të pastër, lidhet me përjetimin e përplasjes:

- Si një ndodhi tipike e rrathëve të çemendura të kanunit, madje edhe e njëfarë pamundësie për ta shmangur këtë lloji ndeshje dhe shpagimi, që buron më shumë prej vetë genit të banorëve të atyre anëve, natyrisht me rrezatime të thekura universale, e cila ka ndodhur këtu e pesëdhjetë vite më përpara, e tashmë në kushtet e ligjit, e ligjëshmërisë së çdo sistemi, është tepër e vështirë që të zgjidhet me ato mjete dhe forma që burojnë prej kanunit, por gjithashtu është jo pak e vështirë për të marrë një përgjigje të drejtë dhe humane qoftë edhe prej ligjit, sado demokratik.

- Si një element i frikshëm dhe plot llahtar, siç dhe përjetohet gjakmarrje dhe ankthi i kanunit, që tashmë edhe merret për gjykim në një kohë tjetër, madje edhe kur ka rënë sistemi i zgjidhjes së përplasjeve të gjakut me anë të kanunit, të rregullave fikse dhe juridike, porse të tejkaluara në kushtet dhe rrethanat e funksionimit të shtetit dhe të ligjëshmërisë, në një kontekst të ri dhe të tjetërsojshëm, kur funksionojnë ligjet dhe shtetit, ndonëse për kohën shkrimore, si dhe për realitetin letrar që projekton autori është diktatura që sundon mbi gjithçka, por njerëzit, personazhet e veprës e bartin dhe e shpalosin me forcë edhe mentalitetin kanunor, mbase si një vel dhe tis i pashqitshëm kaq lehtësisht nga qenia dhe ndërgjegjja njerëzore. Në këtë përplasje (ndeshtrashë), të pashoqe dhe mjaft të vështirë për t' u drejtpeshuar dhe zgjidhur, autori me finesë dhe mjeshtri, me art dhe shprehësi, ka ndërftuar në veprim lojën, lojën e pastër dramatike por edhe me nuanca komizmi të thekur, që shpesh sendrtohet dhe anon nga paradoksi dhe rolit parësor të alogjikes, as gjyq siç e kërkon rregulli ligjor dhe çdo lloji shteti, e as kuvend sipas ligjeve të kanunit të hershëm, një mënyrë kjo e papritur dhe e habitshme, megjithatë e pagjasshme në hapësirat ku edhe sundon ligji dhe shteti, por e pashmangshme në mjedisin ku edhe luhen ngjarjet. Loja, kjo gjetje letrare dhe dramatike autoriale, loja e mrekullishme artistike dhe dramatike, e **Camajt**, kryen dy funksione:

- Edhe të realitetit konkret dhe jetësor, përjetues të gjamës, mbase të ndodhive të përsëritshme në ato anë, por edhe në një hapësirë më të madhe se sa kaq, natyrisht e shoqëruar mjeshtërisht edhe me një përthyerje të dyzuar të kanunit, të mendësisë së mbijetesës shpirtërore të ligjit të moçëm të shqiptarëve, të përhapur në të gjithë trojet, në mungesë të shtetit, por përngjiturazi me të edhe të ligjit shtetëror, që e shmang dhe e bën të panevojshëm veprimin e të drejtës zakonore, pra të kanunit, qa shumë të përfolur dhe të keqkuptuar.

- Edhe të sugjerimit të një realiteti letrar simbolik, pra më tepër imagjinar, të projektuar dhe sendërtuar nga autori pikërisht kështu, ku realja dhe irealja, frymorja dhe e prekshmja, konkretja dhe historikja, ndërthuren ndërmjetshëm kaq fuqishëm, sa për të realizuar një

tekst letrar surreal dhe tepër terheqës. Prania e shenjave konkrete dhe simbolike, imagjinare dhe ireale, jetësore dhe letrare, madje më shumë në një gërshetim të ndërlikuar, të ndërlidhur ndërmjetshëm, i jep dramës së parë të autorit një gjurmë dhe shenjë të prekshe surrealizmi të mirëfilltë, ku gjallojnë dhe frymojnë figura surreale, jetësore dhe fantastike, që e përjashton krejt natyrshëm njëngjyrësinë konkrete.

DRAMATURGJIA E LOJËS MODERNE

Substanca dramatike e shtrirë në dy pjesë kryesore të veprimit dramatik, të këtij teksti dramatik dhe më gjasë më tepër tragjik, dhe në disa pamje (dukë), ku edhe zbulohen dhe portretizohen personazhet kryesorë dhe dytësorë, po ashtu e hapur me një prolog rifromulues të qëndrimit të autorit, si dhe e mbyllur me një epilog me natyrë ritreguese e nodhive të dramës, sendërton një vepër dramaturgjike klasike, në strukturë dhe kompozicion, më të dukshme në rrafshet sipërfaqësore. Porse, po aty dhe diku thellë veprës, më në brendësi të sekuencave dramtike dhe tragjike, e nganjëherë edhe komike, të veprimeve dhe replikave, të unitetit të tekstit letrar, farfuritet dhe shpalohe edhe modernia, madje në kuptimin e parë të kësaj fjale:

- Në dramatikën e veprimit, që mundëson dhe ndikon në shpërfqajen e ndodhive dhe të protagonistëve, nga njëra dukë (pamje), në tjetrën, të cilat në hapësirat e tekstit dramatik lëvizin dhe spostohe sipas parimit të fragmentaritetit, pra të grimcimit të ndodhisë në disa pjesë përbërëse, të cilat megjithatë i ruajnë marrëdhëniet edhe më tërësinë e tekstit të dramës.

- Në dritëhijet që bartin personazhet, pra jo si figurime të ngrira dhe klishe, çka lidhet me portretizimin e tyre si karaktere, me botën e brendshme dhe mendimet e qarta të përfaqësimit, dhe jo si fotografime ideshë. Duke qenë kështu, nën vrundujtë e qëndresës dhe thyerjes, forcës dhe shembjes së papritur, heronjtë e veprës të mbeten në mendje, veçmas për kohenrencën që ravizojnë në të gjithë materien e tekstit, pra ruatjen e tipit si njerëz dhe nivel i

përfaqësimit të grupeve të ndryshme sociale.

- Në hapësirën e zgjeruar të tekstit dramatik, si mjeti adekuat i realizimit të dramës, por edhe të skicimit dhe plasimit të karaktereve të pranishëm, të pasur me shprehje frazeologjike, huajtur në poetikën e gojore, në replikat dhe dialogimin karkaterizues dhe individualizues. Teksti dramatik, i kësaj drame, gjithashtu, sendërtohet me disa rrafshë ndërtekstualiteti, duke fromuluar, formatuar dhe artikuluar modernitetin e brendshëm të dramatikës së autorit.

- Në zgjidhjen e butë, si me thënë në vend të përplasjes së ashpër, që buron prej vetë karakterit të kolizionit dramatik dhe krejt të papritur midis kanunit dhe ligjit, fajtorëve dhe hijeve që çapojnë hapat e jetës, si dhe të fjalëve dhe veprimeve që kryejnë persponazhet kryesorë dhe dytësorë të dramës. Ndarja e merituar nga jeta e protagonistit të veprës, për shkak të veprimeve të tij kryerë në atë drekë të mortshme, por edhe më vonë duke heshtur dhe fshehur të vërtetën e atij tmerrri, duke u endur kështu në atë formësim artistik të shpallur dhe të hapur, vetvetiu shkaton një turbullim ndjesinash, që anësohet nga mëshira dhe urrejtja e shkalafitur, nga mëshira që buron prej nevojës për t' u liruar prej ankthit dhe tmerrit që përçon ndodhia e largët edhe sot e gjithë ditën. Këto shenja letrare të prekshe në realizmin e pjesëve, të pamjeve të shumta, por edhe të prologut dhe epilogut, padyshim edhe të tjera, dëshmojnë qartësisht për shkrimin dramatik me natyrë të pastër moderne. Modernia e prekshe në kompozim, ku ndarjet funksionale vetëm sa e nxjerin në pah këtë tipar, vizatimi i personazheve përmes fjalës dhe veprimit dramtik, e sidomos loja e thuarur, loja dramatike dhe me nuanca të pastra komike dhe tragjike, i japin dramës **Lojë mbasdreke** veti të dukshme të një shkrimi modern, çka e ngjit veprën në nivelin e kryeveprave të autorit, por edhe të teksteve dramatike me vlera, të shkruara në letërsinë bashkëkohore.


RREZATIME TË PËRSOSJES LETRARE

Skenat dhe gjendjet dramatike të veprës, edhe në situatën e ndarjeve në pjesë dhe pamje, pa harruar edhe prologun dhe epilogun, e sidomos sekuencat shkrimore, të tipologjisë së ndërthurjes së teknikave klasike dhe moderne, një përftesë letërsishkrimore e dramatikës, gati e papranishme në letrat shqipe, e shpërfaqin dramën, skenat, dialogun, personazhet edhe me shenjëzime letrare, të përveçuara dhe impresionuese. Shenjëzimet letrare, me rrezatime përsosje janë të prekshe:

Së pari: Në mënyrën e kapërthimit të kolizionit dramatik, i cili bart edhe shenjat dramatike, edhe tragjikomike, që tregon cakun e ndarjes dhe të përbashkimit të dy botëve, të largëta dhe të afërta, përkatësisht të botës së kanunit dhe të asaj të ligjit, jo pak e pranishme në trojet shqiptare në të gjithë historinë. Pikërisht, përplasia e paimaginueshme e këtyre dy botëve, dy mentaliteteve, e formaton konfliktin dramatik, edhe më të fuqishëm edhe më real, madje më artistik në kuptimin e konceptimit të veprës dramatike.

Së dyti: Brenda dramës, pra në materine e tekstit kryesor, mjeshtërisht autori ka ndërshtënë edhe dromca ngjyrimesh tragjike dhe komike, të cilat e kanë nxjerrë në një dritë tjetër situatnë dramatike. Tragjikja, e pranishme në ndodhinë e largët, por edhe në humbjen e heroit qëndror, pra të Zekës, lidhet pandarazi me gjamën e tmerrshme që shkakton gjakmarrja, njëra prej shkatërrueseve të jetës në këto anë. Komikja, nga ana tjetër, një gjetje dhe stileme autoriale, e fytyrëzuar si lojë e lirimit prej makthit të gjakmarrjes, të cilën pamundësisht nuk e ter as koha.

Së treti: Fundi i heroit qëndror, figurës më intertesante dhe më të realizuar të dramës, një mbarim i papritur dhe në logjikën artistike që paraqet ky tekst dramatik. Një fund as tragjik, e as komik, një fund njerëzor ku kandilja e jetës shuhet vetiu, madje duke e merituar këtë fikje. Kjo mënyrë e largimit nga jeta të protagonistit, ndonëse e përfshirë në një lojë tragjikomike, është fati i njeriut, fati i qenies së përkohshme individuale, por edhe i përjetësisë si univers i ekzistencës së qenies njerëzore, e cila në rretheqarkëzimi e kanunit dhe të vështirësive që sjellë ai bëhet edhe më paradoksale.





ZEKA DHE BJESHKA

Një prurje më vete e dramës *Lojë mbasdreke*, një befasi letrare e shkrimtarit në të gjithë pentagramin letrar, është edhe vizatimi i personazheve, përmes dialogut, replikave dhe veprimeve. Në morinë e këtyre personazheve, si më të realizuarit e kësaj veprë, në kuptimin letrar dhe karakterial, janë dy protagonistët e veprës, Zeka dhe Bjeshka. Zeka, sipas gojëdhënës së përhapur atyre anëve, njeriu që shkaktoi tragjedinë në drekën mortore, njeriu që u ka shpëtuar përmbrekulli pritave dhe gjyqeve, njeriu që e pa vdekjen me sy, që vrau sa deshti për të mbetur vetë i gjallë. Po ashtu, dhe kjo shkakton habi tek çdokush, Zeka është edhe njeriu që diti ta fsheh të vërtetën për pesëdhjetë vjet rresht. Ky Zekë burrnor, dredharak gjer në mosqenie, ky burrë që ka bërë për vete vashën e re dhe e ka lidhur pas vetes gruan e bukur të quajtur Bjeshkë. Figura e gruas së Zekës, është tipikisht dhe letrarisht një karakter i besueshëm i atij mjedisi, i cili pjellë krenari dhe nënshtrim ndaj mjedisit, kanunit dhe të parit të shtëpisë. Dy figurat kryesore, ndonëse në ndërlidhje reciproke, janë konceptuar nga autori edhe si kontrast figural, në të gjitha kuptimet e mundshme, fizike, pamore dhe letrare. Megjithatë, kontrasti më i fuqishëm dhe krejt i prekshëm, lidhet me karakterizimin e veçantë që u ka mveshur shkrimtari dy figurave qëndrore të dramës. Nga njëra anë, Zeka si kryehero i veprës, që mbart mbi supet e veta peshën e asaj ndodhie, por edhe të ngjarjeve të mëvonshme, është konceptuar dhe realizuar si personazh kompleks, ku ndërlikimi i qëllimshëm letrar, vetëm sa ndihmon për ta shpërfaqur më të plotë botën e tij. Në anën tjetër, Bjeshka, bashkëshortja e re dhe tepër e mrekullueshme, simbolizon dhe paraqet adhurimin dhe bindjen ndaj Zekës, duke u shpërfaqur në një linjë të njëtrajtshme. Plazmimi i dy personazheve si përplotësues të njëri-tjetrit, dhe të lidhur përjetësisht, aq më tepër me tipare të shenjave karakteriale, i shpërnërron veti në figura të realizuara fuqishëm nga ana artistike.

GJORMI- HIJA E AUTORIT

Një personazh mjaft interesant i dramës, krejt i ndryshëm nga të tjerët dhe tjet funksional në sekant dhe në hapësirat

e tekstit, është Gjormi, malësor tashmë im transformuar në intelektual të një kohe tjetër, që gati i ka shkëputur marrëdhëniet me kanunin, si dhe me rregullat e moçme etike të mbijetesës shqiptare, një figurë ku më së shumti frymon idealiteti autorial, domethënë një allterego e fshru e shkrimtarit. Gjormi, sipas tekstit dramatik dhe situatave që ngreh ai dhe i luan mrekullisht, paraqet një personazh kompleks dhe me kahje të përmbysjes së tipareve mishëruese të përmbysura në këndej kohën, porse ai njëherazi bart edhe një dyzim të prekshëm si figurë dhe karakter:

- Njeriu, të cilit i kanë vlarë gjyshin, pikërisht në atë ndodhi të largët, dhe ai pa vrasje ndërgjejeje është i gatshëm që ta fal gjaksin, madje edhe të bëjë hajgare me të. Ky veprim, i papritur dhe i admirueshëm, natyrisht në pikëpamje të idealitetit, bie ndesh me gjithë mentalitetin e pranishëm në ata zonë, në atë krahinë dhe madje në të gjitha trevat shqiptare, të porsadala nga lufta botërore, por kjo është më e theksuar në pikën e lartë ku edhe luhen ngjarjet e veprës.

- Gjormi, i rritur dhe ndryshuar, burrëruar dhe me ndërgjegje të përmbysur, tashmë avokat, pra i shkolluar në drejtësi, që sapo ka kryer studimet, që nëprmet kësaj ngjarjeje tmerrësisht të hidhur dhe fatale, kërkon vetëm të zbulojë të vërtetën, të vërtetën lakuriqe, ashtu siç ngjau asaj mbasdrekje, sa për të mbrojtur temën e diplomimit, pra të shkollimit të vetë, sa për të prekur realisht rrjedhën dhe përfundimet e saj ndodhie të frikshme edhe mbas kaq e kaq motesh.

- Gjormi si intelektual dhe njeri me shkollë, një personazh më tepër ide, që për shumëçka hiç nuk i përket atij mjedisi ku edhe ngjet tmerrri, por edhe ku luhet pasngjarja. Kuptohet që sipërmarrja për ta falur gjaksin, siç nuk ndodh me këdo të asaj ane, e sidomos sajimi kaq i hollë i lojës, i lojës tragjikomike, i lojës së mendjes për të rrënuar në të kaluarën, e rrëshqet më tepër në tipin e njeriut ideal, që në emër të humanizmit dhe të ideve të kohës del mbi veten, ai kështu siç shpalohej është mbase një alterego e shkrimtarit. Qenësia e tij si e tillë, me këto tre attribute të mirëfillta, edhe me prejardhje nga këto anë, pra si rrënjës është pak e vështirë për ta falur gjakun, por edhe i ndryshuar dhe transformuar, pra i mbingarkuar me veti karakteriale dhe me jo pak ndryshime, bëhet e

prekshme si pentagram i përmbysur edhe nga fakti, që loja më së tepërmi përfaqëson një metaforë të gjetur arti, mbase një simbol të kërkuar dhe artikuluar, me një fjalë një figurim letrar për ta sendërtuar artistikisht kolizionin dramatik, madje nëpërmjet përngjyimeve që bart kjo figurë, duke e spërkatur edhe me ngjyime tragjike dhe komike, ta pasurojë dhe plasojë plotësisht si personazh. Loja metaforë e tekstit si dialog dhe monolog, si ndarje dhe tërësi, e përfshirë në tekstin dramatik, në zbulimin e heronjëve, në shpërndërrimet që ndodhin në ndarjet e shumta që ka ky tekst dramatik, në mënyrë që nga e vjetra, nga e hershmja morale, nga shkatërrimi kanunor, të dilet duke qeshur. Simbolika e lojës, e lojës për shaka, e lojës për të qëmtuar nëpër vatrat ekzistenciale të qenies njerëzore, ideuar dhe realizuar nga Gjormi, e pranuar edhe nga personazhet e tjerë, madje e kryer dhe e përfunduar me kaq sukses me mbështetjen e tyre, buron nga dëshira për t' u dëlirur prej botës së vjetër, që vijon që ta brejë shoqërinë shqiptare, edhe kësaj ndërkohje. Prania e sfondit metaforik dhe simbolik, mbase të dyfishuar si tonalitet, si një shkrirje organike dhe funksionale ndërmejt tyre, ka figuruar dhe pasuruar dramën, ndodhitë dhe veprimet, si dhe replikat që shkëmbejne personazhet në një befasi letrare. Kjo befasi, nga më të spikaturat në krijimtarinë e **Camajt**, duke marrë në shqyrtimi poezinë, prozën, studimet letrare dhe gjuhësore, vjen prej papranisë së pranishme të autorit, e konturuar dhe mishruar në figurën e Gjormit, një malësor i ndryshuar gjer në përmbysje të plotë.

DIALOGU DHE SHPREHJET FRAZELOGJIKE

Veçanësitë e shkrimit të dramës *Lojë mbasdreke*, njëri prej teksteve më të fuqishëm letrar të endur prej autorit, janë të prekshme edhe në dy elementë thelbësor të sendërtimit të veprës:

A – Në dialogun e rrufeshëm, karakterizues dhe identifikues, shenjues dhe shëmbëllyes, i cili në shumicën e dukjeve të të dy pjesëve, e po ashtu edhe në prolog dhe epilog, shpërfaqet si replikë e fortë, e shpejtë, kinse e atypëratyshme, që ndikon drejtpërdrejt në ecjen e veprimit dramatik, aq të tendosur prej karakterit të konfliktit dramatik. Merita e autorit, në këtë aspekt jetik për shkrimin dramatik, ndonëse e ngjyrosur edhe me tone komike dhe tragjike, është karaketrizimi i personazheve, papërrjashtim e të gjithë figurave që parakalojnë në faqet e dramës, sidomos me anë të fjalëve që shkëmbejnë ndërmjetshëm, ku bie në sy skalitja që i bën secilit prej këtyre figurave të kësaj veprë.

B – Prania e frazeologjive, një tipi ligjërimi të ngurosur dhe të huamarrë në poetikën gojore, në replikat që shkëmbejnë mes tyre personazhet, është njëra prej shenjave përveçuese të shkrimit dramatik në këtë tekst. Madje, në një kuptim më të ngushtë dhe letrar, shprehjet frazeologjike, të përpunuara ose të pandryshuara, bartin thelbin e përbashkimit të personazheve që hyjnë e dalin në skenë. Frazeologjitë e tipit: *Fjala në nemë, thanë edhe si për lojë, kumbon fort randë, disa punë të vjetra s' duhet me i përpushë, Punët e vjetra pjellin bolla, Të çova për dru e prune një barrë krande të njoma, Ruaj gjuhë kryet, t' qes burrat e vendit e të kuvendit në gjuhë, me ma lanë mue kopilin te dera, me mbathë pelën me krande* etj. , e përmbysin dhe riformulojnë dialogun e personazheve me një tharm poetik dhe dramatik të habitshëm. Shprehjet frazeologjike, të pranishme në tekst, të përdorura me masë dhe mjeshtri, kryejnë disa funksione artistike:

- Në identifikimin e plotë të mejdisit social dhe dokësor, kohor dhe hapësinor, klasik dhe bashkëkohor, ku edhe luhen ngjarjet e veprës, të cilët ndikojnë në shpalimin e ndodhive, si dhe në përngjyrosjen e tyre me secilin prej këtyre tonave.

- Karakterizimin dhe skicimin e personazheve, të gjithë figurave të dramës, pa bërë dallimin se janë kryesor dhe dytësor, të ultë apo të lartë në kuptimin e shtresëzimit shoqëror, që kanë peshë dhe funksion në skenat e dramës.

- Pasurimin e shprehësisë letrare, veçan në këtë aspekt e pasurojnë dhe ngjyrosin frazën e dramës, të skenave dhe pamjeve të shumta, të dialogut dhe replikave, duke i spërkatur fjalitë dhe gjithë situatën gjuhësore me një tis etik dhe filozofik të ngulitun.

Shkrimtar dhe poet kilian (Roberto Bolaño 1953 – 2003). Iku nga vendlindja që kur ishte ende djalosh i ri duke u endur nëpër Amerikën Latine dhe duke u vendosur për disa vite në Meksikë. Pastaj emigroi në Spanjë (Katalunja), ku jetonte e ëma. Ka bërë punët më të rëndomta si vjelës rrushi gjatë verës, roje nate nëpër kampingje, shitës nëpër lagje, etj., derisa iu kushtua përfundimisht letërsisë. Bolanjo është autor që pranohet si një nga risitë më të mëdha të letërsisë dhe si një nga talentet që fati e mori shumë shpejt. Personazhet e tij janë të çuditshëm, shpesh të rinj romancierë apo poetë që pretendojnë të bëhen të famshëm. Ka botuar 5 vëllime me poezi, 12 romane, 4 vëllime me tregime etj. Romani i tij “Detektivët e egër”, (përkthyer edhe në shqip, nga B. K.) ka marrë çmimin Heralde (1988) dhe atë Romulo Gallego (1999). Pas vdekjes, Bolanjo u bë një ndër shkrimtarët më të rëndësishëm të gjuhës spanjolle. Është futur në 15 vendet e para të listës me 81 shkrimtarë dhe kritikë latinoamerikanë e spanjollë me njëqind librat më të mirë të tyre në gjuhën kastejano për 25 vitet e fundit.

ROBERTO BOLANJO: KUDO NDIHEM I HUAJ

INTERVISTË ME SHKRIMTARIN DHE POETIN E NJOHUR, ROBERTO BOLANJO

Roberto Bolanjo jeton nja dyqind metra nga deti, në Blanes, një qytezë me tridhjetë mijë banorë, gjysmë ore larg Barcelonës. Jeton në një shtëpi me të shoqen dhe dy fëmijët që tani po flenë. Kërkon qetësi në zhurmë, preferon burgun e heshtur e nganjëherë të padurueshëm të të shkruarit. Jashtë, një hënë vjeshtake ndriçon atë çka ka lënë nata. Në korridoret e shtëpisë ka nja tre mijë libra. Bolanjo tymos cigare gjithë lakmi dhe pi Coca-Cola, ngaqë likeri i ka acaruar mëlçinë. Në sytë e tij shkëlqen ironia. Shkrimtari 50-vjeçar kilian nuk i ka qejf intervistat, ai mendon se gjithçka që ka rëndësi janë librat e tij, por, më në fund, pranon të bisedojë mbi disa çështje.

Ju keni punuar me poezinë, gjini çdo ditë më e izoluar nga rrethi botues. Ç'mendoni për poezinë si art dhe si fenomen në kohën e tanishme?

Nuk besoj se poezia do të zhduket. Dyshoj se për njëfarë kohe, poezia po pëson metamorfozë, transformim, hibridim. Sigurisht, sot është e vështirë të shiten shumë libra me poezi, siç ndodhte me librat e Bajronit, ama Lord Bajroni vazhdon të jetë dhe kjo mjafton. Ndoshta poezia tani mbijeton te disa romane. Ose në forma jo të vlerësueshme, forma bastarde, produkte të getove dhe të margjinacionit. Mbase, kur të vdesë poeti i fundit lirik, poezia do të rilindë prej hirit të vet.

Te “Detektivët e egër” ka tema kryesore që spikatin. Një prej tyre është mërgimi, një mërgim që, midis vendeve të tjera, përfshin Meksikën dhe Spanjën...

Interesante është se kurrë nuk jam ndier i mërguar. Ndoshta po, nëse do të kisha jetuar në Suedi, por dyshoj se edhe në Suedi, jo. Ajo që është e vërtetë është se në këto vende jam ndier i huaj, ama i huaj jam ndier kudo, edhe në vendin tim, në Kili. Kam qenë një fëmijë pedant, kësisoj, qysh fëmijë ndiheshja i huaj.

A jeni një i zhgënjyer nga politika apo mërgimi juaj ka të bëjë më shumë me kërkimin e lirisë individuale?

E vetmja liri tek e cila besoj është liria e individit, ose në tërësi te liritë e individëve. Një liri individuale, të cilën e kemi në dorë, mjaft e ndryshueshme, mjaft e paqartë, veç, tani për tani, është e vetmja që kemi. Unë nuk jam një i zhgënjyer nga politika, edhe pse motivet për këtë nuk më mungojnë as mua dhe askujt tjetër, sepse politika, sipas një rregulli të përgjithshëm, është një çerdhe gjarpërinjsh. Vazhdoj të prirem nga e majta, edhe pse e di që e majta, qysh prej më se gjashtëdhjetë vjetësh, qëndron mbi një arsyetim bosh, mbi një shpallje të fryrë që mund t’u shërbejë (kjo ujëvarë e vendeve të zakonshme) horrave sentimentalë. Në të vërtetë, e majta reale është horrlëku sentimental i rafinuar.

Kaq vite pas rënies së dhunshme të Salvador Aljendes, si e kuptoni Kilin që nga larg?

Kam përshtypjen se demokracia po vendoset, e cila tashmë është gjë e madhe, dhe se shoqëria dalëngadalë po mëson të bashkëjetojë. Sigurisht, me koston e sakrificës së kujtesës për disa gjëra, pra, me disa lobotomi.

Cilët shkrimtarë kanë qenë themeli i edukimit

tuaj sentimental letrar dhe cilët nuk do t’i këshillonit për t’i lexuar?

Servantes, Stendal, Rimbó, Poe. Nga secili lexoj çfarë dua dhe çfarë mundem. Të paktën, këtë natë e kam të pamundur të jap këshilla se cili shkrimtar nuk duhet lexuar.

Nga proza aktuale çfarë ju tërheq?

Nga proza latino-amerikane: Rodrigo Rey Rosa, Daniel Sada, Rodrigo Fresán, Alan Pauls.

Ç’mendoni për autobiografinë në letërsi?

Në njëfarë mënyre, gjithçka është autobiografike, ajo çfarë tregohet, kalimthi, kotësia e të shkruarit autobiografi.

Ç’do të thotë për ju data 11 shtator?

Një fatkeqësi. Fillimi i një valleje të ngjashme me atë të San Vitos. Do të thotë rënia e Aljendes, festa kombëtare e Katalunjës që të kujton një tjetër disfatë, sulmi i kamikazëve mbi Kullat Binjake që ishte një disfatë e tretë e kulturës përballë fesë. 11 shtatorin

katalan nuk e kam provuar në mishin tim, por, nëse do ta kisha provuar, do të heshtja, ndryshe do të isha një vampir apo një i pavdekshëm. 11 shtatorin kilian e jetova, e vuajta dhe, meqë isha njëzet vjeç, po ashtu e shijova. 11 shtatori njujorkez më kapi në Milano, ku ndodhesha me time shoqe dhe dy fëmijët tanë. Kur pashë shpërthimin, menjëherë më shkoi mendja tek imazhet që kishim për Luftën e Tretë Botërore, gjatë viteve tetëdhjetë.

Jeni duke shkruar një roman voluminoz, ç’mund të thoni lidhur me këtë?

Ka më shumë se një mijë faqe dhe, siç mund ta marrësh me mend, nuk mund ta thuash me pak fjalë. Të shkruash diçka kaq të gjatë, të lodh. Siç thotë Pavese, të punosh, lodhesh. Edhe unë lodhem, çuditërisht, me një lehtësi të paparë. Por kjo është puna ime dhe duhet të vazhdoj.

Çfarë ju vjen në mendje kur dëgjoni këta emra: Sesar Vajeho (César Vallejo)?

Virtyt dhe shtrembërim. Lirika që vetushqehet.

Huan Karlos Onetti (Juan Carlos Onetti)?

Për më të mëdhenj se tridhjetetë vjeç.

Horhe Luis Borhes (Jorge Luis Borges)?

Zemra e modelit të Amerikës Latine.

Pablo Neruda?

Dy libra të jashtëzakonshëm dhe asgjë më.

Gabriel Garsia Markes (G. García Márquez)?

Një njeri i kënaqur që ka takuar gjithë ata presidentë e kryepeshkopë.

Mario Vargas Josa (Mario Vargas Llosa)?

Njësoj si tjetri, por më i hijshëm.

Gijermo Kabrera Infante (Guillermo Cabrera Infante)?

Një shkrimtar i çuditshëm. Në të vërtetë, nga gjithë këta shkrimtarë që më përmendët, më interesojnë vetëm Vajeho, Oneti dhe Borhes.

Intervistoi: Alfonso Karvahal

Përktheu: Bajram Karabolli





GJEOGRAFIA E MELANKOLISË

*në romanin “Fizika e trishtimit” të shkrimtarit
bullgar Georgi Gospodinov*

nga Ylljet Aliçka

Në vitin 2010 gazeta *The Economist* botoi një artikull mbi “gjeografinë e lumturisë”, ku Bulgaria së bashku me Rumaninë u deklaruan si vendet më të mërzhitshme në botë. Shqipëria nuk figuronte në këtë klasifikim.

Një vit më vonë shkrimtari bullgar, Georgi Gospodinov, botoi romanin e tij, “Fizika e trishtimit” gati si një përgjigje ndaj artikullit të mësipërm, por në një plan më të gjerë, ndofta si reagim ndaj klisheve perëndimore në lidhje me temperamentin e Evropiano-lindorëve.

Jo rrallë herë dëshmuar kjo dhe nga përvoja shqiptare ku ndjeshmëritë ndërkombëtare ndaj vendit janë dallaur për prirje standartizimi, retorika të konsumuara, këndvështrime sensacionale, apo ekzotike, të cilat kanë ofruar hapësirë të mjaftueshme për opinione të deformuara,

Por, a mund të flitet, pra, për një hierarki apo shtrirje gjeografike të trishtimit?

A ka secili komb mënyrën e tij të trishtuarit, sipas parimit kultura të ndryshme kanë forma dhe përmbajtje të standartizuara trishtimi. Thënë ndryshe, a ka secili komb larminë e tij të melankolisë, dhembjes, zhgënjimit?

Apo, së fundi, a është trishtimi aq sa universal, po aq dhe individual dhe se secili ka mënyrën dhe shkaqet e veta të trishtuarit, pra mënyrën e tij të pikëllimit?

Janë mëdyshje e dilema që dalin nga vetë leximi i romanit “Fizika e trishtimit”.

Gospodinov përpiket të tregojë pikërisht një histori të tillë, duke i kundërvënë “vendit më të mërzhitshëm në botë”, pra Bullgarisë, trishtimin e vet, trishtim ky që

sipas shkrimtarit kërcënon të pushtojë krejt Europën.

Fare lehtë, atë mund ta quash dhe *Kronikan i ironik i jetës së përditshme bullgare*, në një kohë kur epikave sublime i ka ikur tashmë koha, dhe jo vetëm në Bullgari,

Fjala është për një roman që, kur u botua në vitin 2012 në Bullgari, kontigjenti i parë u shit brenda ditës, për të marrë më pas të gjitha çmimet kryesore brenda dhe jashtë vendit e për tu përkthyer në mbi 16 gjuhë.

Nuk është e lehtë të bësh një shkrim përmbledhës për romanin “Fizika e trishtimit”, pasi aty Gospodinov përzjen historitë e vogla personale me historinë e madhe njerëzore, vepra kryqëzon disa tregime, nga vetëm një rrëfimtari, nganjëherë unik, nganjëherë shumplanësh, një katalog vëzhgimesh joshëse.

Vetë titulli “Fizika e trishtimit”, një bashkim i dy termave dalë nga regjistra leksikorë rrënjësisht të ndryshëm (fizika është karteziante, ndërkohë që melankolia është më pikëlluese, më e avullt, subjekt luhatjesh kapriçioze....) lë të mendosh se individ i njeri është një univers më vete, dhe se ekzistojnë aq universe të veçanta melankolie sa dhe individë.

Natyrë melankolike, i brishtë, me ndjesinë e fëmijës së braktisur dhe diagnostifikuar që në moshë të hershme me sindromën somatiko-empatike obsessive, (empati e pavullnetshme) bën që ai të përfshihet dhe futet në përvojën e gjithçkaje rrotull tij, familiarët, fqinjët, kafshët, madje dhe ndaj një kërmilli që gëlltit gjyshi I tij për të lehtësuar ulcerën e stomakut.

Ai ka aftësinë të hyjë sa brenda trupit dhe shpirtit të të vet, aq dhe duke u shkrirë në trupin e shpirtin e një të tjetrit, për ta ndjerë atë më mirë, duke kaluar

nga veta e parë në atë të tretë, duke mbushur kështu hendekun mes vetes dhe tjetrit.

Eshtë kjo prirje për të shkrirë “unin” me “ai” dhe “ne” që të bën të kujtosh devizën “unë jemi ne”.

Gjithçka në roman është e krijuar dhe njëkohësisht reale, fluide, e huaj dhe njëkohësisht familiar, duke përmbledhur histori që lidhen e shkëputen herë pas here. Me një vështrim të ndjeshëm mbi shoqërinë ai përpiket të tregojë trishtimin e llojit bullgar, poaq si dilemë gjuhësore, aq dhe metafizike, ku secili individ është i pangjashëm në melankolinë e tij, në kërkim të vetes, ku ndërthuren e kaluara me të sotmen, personalja me universalen, kujtesa kolektive me atë individuale, ndjenjat sublime me melankolinë.

Gospodinov i largohet temave të mëdha, kategorizimeve morale dhe përshkrimeve, duke ofruar në vend të tyre një polifoni mikrokronikash të çastit, me hapësirë ndaj formave të tjera të trishtimit.


Teksa kalon nga njëri identitet në tjetrin: fëmijë, adult, gjysh, apo duke u shëndrruar në figurën emblematike të mitologjisë greke Minotaur, (të cilën ai e punëson dhe shfrytëzon si një metaforë komplekse), të duket sikur ai i përdor personazhet e tija për të ngazëllyer frikërat e veta.

Dikush që ndjen nevojën të kuptojë dhe pranojë melankolinë e tij, në kërkim të vetes së tij: një vajtje ardhje mes emocionit dhe analizës, lexuesit, tregimtarit, shkrimtarit, që nuk rreshtin së identifikuari, e së ndari, duke theksuar kësaj të gjitha format e empatisë dhe dhembshurisë.

Fare lehtë shkrimtarin mund ta quash *Kronikan i jetës së përditshme bullgare*, në një kohë kur epikave sublime i ka ikur tashmë koha, dhe jo vetëm në Bullgari. Tekefundit ajo gjithçka që na mbetet është rutina e mërzhitshme e jetës së përditshme. Ai na fton të gjejmë një mënyrë për të bashkëjetuar me trishtimin, për ta lejuar atë si burim empatie, për tu ballafquar me hezitimet apo mëdyshjesh tona të përditëshme, antidot ky mjaft efikas ndaj zymtësisë së jetës.

Me një lehtësi dhe fluiditet, në dukje konfuz, romani presupozon detyrimisht pjesmarrjen e lexuesit në një bashkëveprim real, aq sa nganjëherë është e pamundur të mos ndalosh leximin, për ta rilexuar,

Dhe së fundi, nuk duhet të ketë qenë aspak e lehtë për përkthyesen Milena Selimi, me përkthimin e këtij romani labirinth, me shumë lojë fjalësh, atmosferë, poezi, referenca kulturash të ndryshme e duke ruajtur njëkohësisht formulimin atipik dhe muzikalitetin e gjuhës së shkrimtarit.





ISABEL ALLENDE: Pse shkruaj

E kam të nevojshme të rrëfej histori. Është ide e ngulitur. Secila prej tyre është një farë brenda meje që fillon të rritet e rritet, si tumor, dhe herët a vonë duhet të merrem me të. Pse një histori e veçantë? Nuk e di kur e filloj. E mësoj shumë më vonë. Me kalimin e viteve kam zbuluar se të gjitha historitë që kam rrëfyer, të gjitha ato që do të rrëfej, janë të lidhura me mua. Nëse po rrëfej për një grua në kohët Viktoriane, e cila lë shtëpinë që i ngjall siguri dhe vjen në Gold Rush të Kalifornisë, në të vërtetë po flas për feminizmin, çlirimin, për atë që kam kaluar në jetën time, duke u arratisur nga një familje kiliane, katolike, patriarkale, konservatore, viktoriane për të dalë në botë.

Kur filloj të shkruaj një libër, as që e kam idenë se çfarë drejtimi do të marrë. Nëse është roman historik, afërmendsh që kam studiuar periudhën dhe vendin, por s'e di se çfarë historie dua të tregoj. Di vetëm se me shumë kujdes, pa u vë në re, dua të ndikoj në zemrën dhe mendjen e lexuesit.

Ndoshta është befasi për lexuesit e mi të dinë se sa shumë kujdesem për gjuhën. Si e lexoj me zë të lartë një paragraf dhe nëse ka fjalë të përsëritura, s'e pëlqej. Me përkthimin në anglisht merrem rresht për rresht. Zakonisht përkthyesi më dërgon njëzet apo tridhjetë faqe të përkthyesa, dhe nëse shoh ndonjë fjalë që s'përputhet saktësisht me kuptimin që i kam dhënë, hap fjalorin. Tregohem shumë e vëmendshme sepse

kjo është e vetmja lëndë që kemi: fjalët. Por ato janë të lira. Pavarësisht se sa rrokje kanë: janë të lira! Mund të përdorni sa të doni, përherë.

Shkruaj spanjisht. Mund të shkruaj një fjalim në anglisht, por krijimi letrar ngjizet në mitër. S'e përpunoj dot në mendje derisa të bëj redaktimin. Rrëfimi i historive më vjen në spanjisht. Mundohem të shkruaj bukur, por kuptueshëm. Në spanjisht, frëngjisht, italisht, ka një mënyrë të stërholluar për t'i thënë gjërat, gjë që nuk ekziston në gjuhën angleze. Im shoq thotë se ai e kupton gjithmonë kur merr një letër të shkruar në spanjisht: zarfi është i rëndë. Në anglisht një letër është e gjatë sa një paragraf. Hyn drejt e në temë. Në spanjisht kjo është e pasjellshme.

Leximi në anglisht, të jetuarit me anglishten, më ka mësuar ta bëj gjuhën sa më bukur të jetë e mundur, por të saktë. Mbiemra të tepërt, përshkrime të tepërta, hiqi, janë të panevojshme. Të folurit e anglishtes e ka bërë për mua të shkruarit më pak të paqartë. Përpiqem të lexoj *Shtëpia e shpirtrave*, por s'mundem. Zot i madh, sa shumë mbiemra! Pse? Thjesht përdorni një emër të mirë në vend të tre mbiemrave.

Të gjithë librat i filloj më tetë janar. Mund ta imagjinoni shtatë janarin? Ferri vetë. Çdo vit, në shtatë janar, përgatis hapësirën time fizike. Heq të gjithë librat e tjerë. Lë vetëm fjalorët, dhe botimet e mia të para, si dhe materialet kërkimore për librin e

ri. Dhe pastaj, më tetë janar bëj shtatëmbëdhjetë hapa nga kuzhina tek shtëpiza me pishinë ku kam zyrën. Ngjan me udhëtimin në një botë tjetër. Është dimër, dhe zakonisht bie shi. Shkoj me çadër kurse qeni më ndjek nga pas. Pas këtyre shtatëmbëdhjetë hapave, jam në një botë tjetër dhe jam një njeri tjetër. Mbërrij atje e frikësuar. Dhe e ngazëllyer. Dhe e zhgënjyer - sepse kam një lloj ideje që s'është në të vërtetë ide. Dy, tre, katër javët e para ikin kot. Thjesht shfaqem para kompjuterit. Shfaqem, shfaqem, shfaqem, dhe pas njëfarë kohe shfaqet edhe muza. Nëse s'shfaqet e ftuar, në fund fare thjesht ia beh. Atëherë jeta ime ndryshon. Bëhet një proces krejtësisht i ndryshëm ngazëllimi, idengulitjeje, dhe stresi. Mund të punoj katërmëdhjetë orë. Vetëm të rris ulur për aq kohë është shumë është e vështirë! Im bir e ka programuar kompjuterin në mënyrë që çdo dyzet e pesë minuta të detyrohem të ngrihem. Nëse nuk e bëj, ngec aty deri fund të ditës. Korrigjoj deri në rraskapitje, dhe më në fund them se duhet ta lë. Dorëshkrimi asnjëherë nuk përfundon plotësisht, dhe mendoj se gjithmonë mund të përmirësohet, por bëj më të mirën. Me kalimin e kohës, kam mësuar të shmang korrigjimin e tepërt. Kur mora kompjuterin e pare kuptova se sa e lehtë ishte të ndryshoja gjërat pafundësisht, ndaj stili im u bë shumë i vështirë.

Ka një bukuri të veçantë tek ajo që është e vetvetishme. Dua që lexuesi ta ndiejë se po ia rrëfej historinë atij ose asaj në veçanti. Kur i tregoni një histori në kuzhinë një miku, është plot gabime dhe përsëritje. Këtë mundohem ta shmang në letërsi, por prapë dua që të ngjajë me një bisedë, siç është zakonisht rrëfimi i historive. Por të mos jetë leksion. Është e vështirë ta gjesh këtë ekuilibër. Por kam tridhjetë vjet që shkruaj, kështu që tani e di se kur e teproj. E lexoj me zë të lartë, dhe nëse nuk tingëllon njësoj sikur flas, e ndryshoj. Duhet të jem shumë e kujdesshme me dialogun, sepse librat e mi janë përkthyer në tridhjetë e pesë gjuhë. Është e vështirë ta përkthesh dialogun. Ligjërimi bisedor ndryshon dhe libri bëhet demode. Asnjëherë s'dihet se si bisedat e personazheve të tu do të përkthehen në rumanisht apo vietnamisht. Kështu që s'përdor shumë dialogë. Kur e përdor, përpiqem të jetë vërtet i thjeshtë.

Në të gjitha librat e mi ka gra të forta që duhet të kapërcejnë pengesa të jashtëzakonshme për të patur fatin e tyre. S'po përpiqem të krijoj modele që të imitohen nga gratë. Thjesht dua që gratë e mia lexuese të gjejnë forcën e nevojshme. Dhe dua që lexuesit e mi meshkuj të kuptojnë se çfarë do të thotë të jesh femër - të gjejnë ndjenjën e mirëdashjes.

Kur tregoj historinë e skllavërisë, e tregoj nga këndvështrimi i skllavit. Po kështu hyj në zemrën e padronit. Dua që lexuesi im ta ndiejë skllavin, ta kuptojë se çfarë do të thotë të mos kesh liri. Në romanin *Ishulli nën det* (2009), skllavja nuk mund të ishte ndryshe nga unë fizikisht ose emocionalisht. Ajo është një grua e gjatë afrikane. Megjithatë e di se si do të ndihesh po të isha në vendin e saj. Kur shkruaj, jam skllave. Jam në plantacion. Ndiej nxehtësinë, nuhas erërat. Të jesh nën pushtetin e krijimit të një historie, është sëmundje. Mund ta mbaj historinë me vete gjithë ditën, gjithë natën, në ëndrra, gjatë gjithë kohës. Me gjithçka që shoh, me gjithçka që ndodh, më duket se universi po më flet sepse ato i lidh me historinë. Ndiem e pamposhtur. Mund të jetë historia më e tmerrshme, por ndihem plotësisht e lumtur. Kur po shkruaja *Ishulli nën det*, u sëmura aq keq sa mendova se kisha kancer në stomak. Kisha të vjella dhe nuk shtrihesha dot. Duhej të flija ulur. Im shoq tha: "Trupi yt po reagon ndaj historisë që po shkruan. Kur ta mbarosh librin, do të jesh mire". Dhe ashtu ndodhi.

Kam fituar vlerësime dhe çmime. Librat e mi janë bërë filma dhe drama. Madje isha mbajtëse e flamurit në Lojërat Olimpikë Dimërore 2006 në Torino, Itali. E imagjinoni dot? Hyra në stadium pas Sofia Lorenit dhe para Susan Sarandonit. Kam një fotografi fantastike gjatë ceremonisë. Shihet Sofia Loren, e bukur, e gjatë, elegante, dhe më pas flamuri, dhe Susan Sarandoni, gjithashtu e bukur. Unë jam e gjatë një metër e

pesëdhjetë e dy dhe jam nën flamur. Jam e padukshme.

Por koha më e mirë ishte viti 1981, kur shkruaja romanin e parë. S'kisha asnjë ambicie, asnjë shpresë se do të botohej, asnjë lloj trysnie. S'e dija nëse isha shkrimtare, e mora vesh vetëm pasi mbarova librin e katërt, kështu që s'kisha pritshmëri, por thjesht lirinë e të treguarit të një historie për qejf. Punoja në kuzhinën time në Caracas natën, shtypja në një makinë të vogël shkrimi. Në një makinë shkrimi! Kështu që s'mund të bëja gabime. Kur mbarova librin ia tregova nënës. Ajo tha: Pse personazhi më i keq në libër ka emrin e tët ati?" S'e kam takuar kurrë tim at, por i thashë: "S'ka problem, do ta ndryshoj emrin". Kështu m'u desh që për atë persoanzh të gjeja një emër me të njëjtin numër shkronjash, dhe më pas ta shkruaja emrin e ri në pesëqind faqe, në secilën prej tyre. I prisja faqet me gërshtëri dhe ngjisja me ngjithës korrigjimet. Disa faqe kishin kaq shumë korrigjime, sa më dukej se mund të ngriheshin në këmbë dhe të ecnin. Por sa shumë liri kisha gjatë të procesit të shkrimit! Ishte kohë e mrekullueshme, sepse nuk e visja mendjen për asgjë përveç historisë që po rrëfeja. Mbaja me vete një kopje të librit kudo ku shkoja, në gjoks, si një foshnjë të porsalindur.

Koha më e keqe ka qenë kur ime bijë, Paula, vdiq më 6 dhjetor 1992. Më 7 janar 1993, nëna më tha: "Nesër është tetë janari. Nëse nuk shkruan, do të vdesësh. Më dha 180 letrat që i kisha shkruar kur Paula ishte në gjendje kome, dhe më pas ime më vajti në pazar. Kur u kthye gjashtë orë më vonë, unë po mbytesha në lot, por kisha shkruar faqet e para për Paulën. Të shkruarit gjithnjë vendos një lloj rendi në kaosin e jetës. Më organizon jetën dhe kujtesën. Edhe sot e kësaj dite, përgjigjet e lexuesve më ndihmojnë ta ndiej të gjallë bijën time. Por pasi shkrova romanin "Paula", përjetova bllokimin e shkrimtarit. Përpiqesha të shkruaja çdo ditë, por kisha shteruar. Pas dy vitesh dëshpërimi, takova Annie Lamott në librarinë tonë lokale *Book Passage*. Ajo më pyeti nëse të shkruarit po ecte mirë. I thashë jo, isha më keq. Ajo tha: - Oh, Isabel, është shterur rezervuari yt. Duhet ta mbushësh që të shkruash. E pyeta: - Po si mund ta mbush? Annie tha: - Ke për ta gjetur një mënyrë. Dhe kishte të drejtë. Shkova me tim shoq dhe një mik në Indi. Kjo më shkundi. Pyeta veten: -Pse të ankojem dhe rënkoj kur ka kaq shumë pikëllim dhe çudi në botë? Kush jam që të përqendrohem vetëm te vetja?" Kjo ishte diçka e mrekullueshme.

Kur u ktheva në shtëpi, ende s'mund të shkruaja letërsi, kështu që i caktova vetes një detyrë. I thashë vetes që mund të shkruaj për gjithçka, për sa kohë që s'është politikë ose futboll. Më duhej një temë sa më e largët me temën e Paulës. Kështu që shkruaja *Afërdita*, një libër joletrar për seksin dhe të ngrënit e tepërt. Prandaj tani kurdo që përjetoj bllokimin si shkrimtare, e di se mund të merrem me shkrime joletrare. Shkrimi i kujtimeve ka përparësitë e veta. E di që nuk mund të shantazhohem kurrë, sepse s'mbaj sekrete. Por ende kam sidoqoftë frikë nga gjendja e pamundësisë për të shkruar. Është si të të gëlltisë një ranishtë. E tmerrshme

Rrëfimi i historive dhe letërsia do të ekzistojnë gjithmonë, por çfarë forme do të marrë? A do të shkruajmë romane për t'u realizuar në skenë? Rrëfimi i historive do të ekzistojë, por si, nuk e di. Mënyra se si tregohen sot historitë e mia është botimi në formën e një libri. Nëse në të ardhmen, nuk do të jetë kjo mënyra e rrëfimit të një historie, do të përshtatem.

Gjuha: kjo është ajo që ka rëndësi për mua. Të rrëfesh histori për të krijuar një emocion, një tension, një ritëm, kjo është ajo që ka rëndësi. I vlen të mundohesh për të gjetur fjalën e saktë që krijon një ndjenjë ose përshkruan një situatë. Përdorni një fjalor, përdorni imagjinatën, vrisni mendjen derisa të vijë, por gjeni fjalën e duhur. Kur mendoni se historia po fillon të ket ritëm, personazhet po formësohen, mund t'i shohësh, mund të dëgjosh zërat e tyre dhe po bëjnë gjëra që s'i ke pasur ndër mend dhe s'mund t'i imagjinoje, atëherë dije se libri është diku, thjesht duhet ta gjes, dhe ta sjellësh, fjalë për fjalë, në këtë botë.

FJALIMI I ISABELLE ALLENDE-S NË CEREMONINË E ÇMIMEVE KOMBËTARE TË LIBRIT, SHBA

A keni një enciklopedi apo një libër telefonik që të mund të mbështetem në diçka?

Faleminderit, faleminderit shumë për këtë nder të papritur që e pranoj me përulësi, në emër të miliona njerëzve si unë që kanë ardhur në këtë vend në kërkim të një jete të re. Kam qenë gjithmonë e huaj, jam lindur në Peru dhe jam rritur në Kili në shtëpinë e gjyshit tim. Ndoqa njerkun në udhëtimet e tij si diplomat. Isha refugjate politike për 13 vjet në Venezuelë pas grushtit ushtarak të vitit 1973 që i dha fund një tradite të gjatë të demokracisë në Kili. Dhe kam qenë emigrante në Shtetet e Bashkuara për më shumë se 30 vjet.

Të qenit e çrrënjësor kronike ka disa përparësi. Pjesa më e madhe e shkrimeve të mia lindi nga nostalgjia, humbja dhe ndarja, nga një dëshirë e pashërueshme që t'i përkas një vendi. Kam pamjen e një kilianeje, dhe ëndërroj, gatuaj, bëj dashuri dhe shkruaj spanjisht. Bëj dashuri: do të ishte qesharake të dihasja në gjuhën angleze. I dashuri im nuk flet asnjë fjalë spanjisht. Kam një të dashur në moshën 76 vjeçare, nuk e besoni apo jo. Ai është i guximshëm.

Si e huaj, s'e marr asgjë për të mirëqenë. Vëzhgoj dhe dëgjoj me kujdes. Bëj pyetje dhe vë në dyshim gjithçka. Për shkrimet e mia nuk kam nevojë të trilloj shumë, shoh përreth dhe mbaj shënime, jam koleksioniste e përvojave. Mbështetem në jetën e njerëzve të tjerë, veçanërisht në gratë e forta dhe plot pasion që takoj kudo. Mbështetem në hidhërimin dhe në vështirësitë e çdo dite, në gëzimin e të qenit gjallë dhe nuk kam frikë nga vdekja por nuk kam frikë as nga jeta. Refuzoj të jetoj me frikë dhe as që bëhet fjalë të votoj me frikë.

Kjo është një kohë e errët miqtë e mi, është kohë lufte në shumë vende, dhe kohë lufëtrash të mundshme kudo. Është kohë nacionalizmi dhe racizmi, mizorie dhe fanatizmi, një kohë ku vlerat dhe parimet që mbështesin qytetërimin tonë janë të rrethuara. Është kohë e dhunës dhe varfërisë për shumë njerëz. Mijëra njerëz detyrohen të lënë gjithçka të tyre dhe të ndërmarrin udhëtime të rrezikshme për të shpëtuar jetën.

A ju kujtohet fëmija i vogël 3 vjeçar sirian, trupin e të cilit oqeani e nxori në një plazh në Turqi në vitin 2015? Emri i tij ishte Alan Kurdi. Ai mund të ishte djali juaj ose nipi im. Po atë ditë, babai i tij humbi gruan dhe një fëmijë tjetër në gomonen ku kishin hipur për të kaluar detin për të shpëtuar nga lufta në Siri. Alan Kurdi simbolizon gjendjen e miliona njerëzve të dëshpëruar. Për një çast bota u trondit nga imazhi i foshnjës së vdekur në plazh, por shpejt e harroi.

Shkruaj për ta ruajtur kujtesën nga gërryerja e harresës dhe për t'i bërë bashkë njerëzit. Besoj në fuqinë e historive të rrëfyera. Nëse dëgjojmë historinë e një personi tjetër, nëse tregojmë historinë tonë, fillojmë të kapërcejmë ndarjen dhe urrejtjen. Sepse e kuptojmë se ngjashmëritë që bashkojnë janë shumë më tepër sesa dallimet që na ndajnë.

Shkruaj gjithashtu për të kuptuar. Çfarë është shkrimi në fund të fundit, përveçse një përpjekje për të zgjidhur pështjellimin e e jetës. Shpesh nuk e di pse ndihem e detyruar të shkruaj një histori të caktuar dhe vetëm më vonë e kuptoj se është e lidhur me një pjesë të jetës sime, ose të psikikës sime, që më duhej ta kuptoja dhe nganjëherë ta shëroja.

Për ata që nuk i kanë rrënjët në një vend, kujtesa është thelbësore për të ruajtur ndjenjën e vazhdimësisë. Askush nuk e dëshmon jetën tonë, duhet të kujtojmë. Dhe çfarë do të bënte një shkrimtar pa një ndjenjë të fortë të së kaluarës, pa një idengulitje me kujtesën? Nuk e di se sa nga kujtesa ime është fakt i vërtetë dhe sa kam trilluar. Ndoshta mbaj mend atë që kurrë nuk ka ndodhur. Kujtesa është subjektive, kushtëzohet nga emocioni dhe besimi. Historia jonë është gjithashtu subjektive. Ne zgjedhim se çfarë të nxjerrim në pah dhe çfarë të shpërfillim apo harrojmë. Zgjedhim mbiemrat për të përshkruar udhëtimin tonë dhe në këtë mënyrë krijojmë legjendën tonë. Unë kam krijuar për veten time një legjendë më të madhe se jeta, ndoshta për të kompensuar shtatin tim të shkurtër.

Në këtë tokë, të gjithë e kanë origjinën nga dikush që ka ardhur nga një vend tjetër. Dallimi i vetëm midis meje dhe teje, nëse nuk ka një amerikan vendas në audiencë, është se gjyshërit tuaj kanë ardhur këtu të parët. Unë jam thjesht pjesë e kësaj diasporës së madhe, dhe megjithëse jam kritikuar për shumë gjëra rreth këtij vendi, jam krenare që jam qytetare amerikane.

Kam marrë shumë më tepër nga sa kam ëndërruar dhe më është ofruar mundësia që të kthej diçka. Ky çmim kombëtar është një dhuratë e jashtëzakonshme për mua, do të thotë se ndoshta në fund të fundit nuk jam e huaj. Do të thotë se ndoshta është koha për të mbjellë rrënjët e mia dhe të pushoj. Ndoshta kam gjetur një vend ku mund t'i përkas. Ndoshta nuk do të shkoj më askund.

Isabelle Allende (1942-) u bë autorja e parë që shkruan në gjuhë spanjolle e cila u nderua me Çmimin e Karrierës në ceremoninë e Çmimeve Kombëtare të Librit, SHBA (14 Nëntor 2018) për kontributin e shquar në letrat amerikane. Fjala e mbajtur me rastin e pranimit të çmimit u mirëprit nga publiku dhe bëri jehonë në median e shkruar.

Përktheu: Granit Zela



ADIL OLLURI

BARTËSI I SHPIRTRAVE TË PËRZËNË

OnufriRoman

